

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6776
E mërkurë, 7 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

UNË, STUDENT POLITIK I MAO CE DUNIT, ZAJEBNICA NUK KALON!

FAQE 5

Behxhet Sh.
SHALA – BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INCIDENTE NË VERI GJATË PËRGATITJEVE PËR ZGJEDHJE | FAQE 4-5


AMBASADORI HOVENIER: NUK KA KUSHTE PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE NË VERI



Disa grupe të qytetarëve serbë në Zubin Potok dhe Mitrovicë të Veriut penguan të martën hapjen e zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shkaktuar edhe incidente, por pa pasoja në njerëz. Në këto dy komuna, ashtu si edhe në Zvečan dhe Leposaviq, pritet të mbahen zgjedhjet për kryetarë më 18 dhjetor. Kryetari i KQZ-së,

Kreshnik Radoniqi, ka theksuar se incidentet në veri dëshmuar se qasja e KQZ-së është e kufizuar në këtë pjesë të vendit. Ndërkaq ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka pohuar se nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve në veri, duke theksuar se siguria e të gjithë qytetarëve të Kosovës duhet të jetë prioriteti më i lartë

AKTUALE



LV-JA PËR QEVERISJEN E
PËRPARIM RAMËS:
NJË VIT ME KAOS | F. 5

ARRESTOHEN 25 ANËTARË TË
GRUPIT QË DYSHOHEJ SE PO
PLANIFIKONTE GRUSHTSHTET NË
GJERMANI | F. 2

KURTI: RASTI I MJEDRAVE ËSHTË
NJË NGA SHEMBUJT E
POTENCIALIT TONË EKSPORTUES

F. 8

EKONOMI



KRIZA ENERJETIKE, EKSPERTËT
KËRKOJNË TË ANALIZOHET
MUNDËSIA E PRODHIMIT TË GAZIT
NGA LINJITI | F. 8

GUVERNATORI I BQK-SË:
KONTRIBUTET PENSIONALE
DUHET TË SHFRYTËZOHEN
PAS PENSIONIMIT | F. 8

SPORT



EKIPI NGA UEFA GROW,
ME PËRSHTYPJE NË KOSOVË | F. 10

GJERMANIA
ZOTON
37 MILIONË
EURO
PËR TA
PËRAFRUAR
KOSOVËN
ME BE-në | FAQE 3



KUVENDI PËR NËNTË
MUAJ SHPENZOI MBI
4.6 MILIONË EURO PËR
PAGA E MËDITJE | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Arrestohen 25 anëtarë të grupit që dyshohej se po planifikonte grushtshtet në Gjermani

BERLIN, 7 DHJETOR - Pas bastisjes së dhjetëra lokacioneve në 11 shtete federale të Gjermanisë, policia gjermane ka arrestuar 25 persona, të cilët dyshoheshin për komplot për rrëzimin e qeverisë. Ata thuhet se i përkasin një grupi të ekstremit të djathtë. Prokurorët federalë thanë se në këtë aksion kanë marrë pjesë rreth 3 000 policë, të cilët kryen bastisje në 130 lokacione.

Ministri i Drejtësisë, Marco Buschmann, e përshkroi aksionin si "operacion anti-terrorizëm" dhe tha se dyshohet se grupi kishte planifikuar një sulm të armatosur ndaj institucioneve të shtetit.

Raportimet në mediet gjermane thonë se grupi i përbërë nga figura të ekstremit të djathtë dhe ish-ushtarakë kishte bërë "përgatitje konkrete" për ta sulmuar ndërtesën e Parlamentit, Reichstag, për ta marrë pushtetin.

Sipas autoriteteve gjermane, 22 nga 25 të arrestuarit janë shtetas gjermanë, ndërsa tre të tjerë, përfshirë një shtetas rus, dyshohet se e mbështesnin grupin.

Në krye të grupit dyshohet se ishte një 71-vjeçar, të cilit i

referoheshin si princi Heinrich XIII.

Prokurorët federalë thanë se grupi planifikoi që ta instalonte atë si udhëheqësin e ri të Gjermanisë, dhe për këtë arsye vetë 71-vjeçari dyshohet se kishte kontaktuar me zyrtarët rusë me qëllim të negociimit të një rendi të ri në vend, pasi qeveria gjermane të rrëzohej. Ai dyshohet se u ndihmua nga një grua ruse, Vitalia B.

Prokurorët identifikuan edhe një person tjetër të ndaluar nga policia.

Gazeta gjermane "Der Spiegel" raportoi se ajo është gjyqtare dhe ish-deputete e partisë së ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë.

Partia, e njohur me akronimin e saj gjerman AfD, është vënë gjithnjë e më shumë nën vëzhgimin e shërbimeve gjermane të sigurisë për shkak të lidhjeve të saj me ekstremistët.

Bashkëdrejtuesit e AfD-së, Tino Chrupalla dhe Alice Weidel, dënuan planet e raportuara, për të cilat ata thanë se i kishin mësuar vetëm përmes raportimeve në medie. "Ne kemi besim të plotë në autoritetet e përfshira dhe



kërkojmë një hetim të shpejtë dhe gjithëpërfshirës", thanë ata në një deklaratë.

Ministrja e Brendshme, Nancy Faeser, tha se bastisjet treguan se "ne dimë të mbrohemi kundër armiqtë të demokracisë". "Vetëm hetimi i mëtejshëm do të tregojë një pamje të qartë se sa larg kishin arritur planet për grushtshtet", tha ajo.

Zyrtarët kanë paralajmëruar

vazhdimisht se ekstremistët e ekstremit të djathtë përbëjnë kërcënimin më të madh për sigurinë e brendshme të Gjermanisë.

Kryeprokurori federal i Gjermanisë pritet të deklarohet për medie më vonë gjatë ditës.

Pjesë e këtij grupi thuhet se janë anëtarë të lëvizjes ekstremiste "Reichsbuerger" apo "Qytetarët e Rajhut", të cilët janë prej kohësh në vëzhgimin e policisë

gjermane për sulme të dhunshme dhe teori konspirative raciste.

Ata, gjithashtu, refuzojnë ta njohin shtetin modern gjerman.

Rreth 50 burra dhe gra dyshohet se kanë qenë pjesë e grupit që thuhet se kanë bërë komplot për ta përmbysur Republikën dhe për ta zëvendësuar atë me një shtet të ri të modeluar sipas Gjermanisë të vitit 1871.

Demokratët forcojnë kontrollin e Senatit pas fitores në Xhorxhia



WASHINGTON, 7 DHJETOR - Pas fitores në shtetin e Xhorxhias, demokratët kanë forcuar kontrollin në Senat.

Senatori demokrat Raphael Warnock fitoi përballë republikanit Herschel Walker në balotazhin e zgjedhjeve në Xhorxhia të martën, duke u siguruar demokratëve një shumicë në Senat për pjesën tjetër të mandatit të presidentit Joe Biden. "Unë shpesh them se

vota është një lloj lutjeje për botën që dëshirojmë, për veten dhe për fëmijët tanë", tha Warnock, një pastor baptist dhe senatori i parë me ngjyrë i shtetit të tij.

Me fitoren e Warnock demokratët do të kenë një shumicë 51-49 në Senat, duke siguruar epërsi pas ndarjes aktuale 50-50.

Balotazhi i dhjetorit në Xhorxhia ishte përcaktues për ndaljen e

ulëseve në Senat mes dy partive. Këto janë rezultatet më të mira të Partisë Demokratike në zgjedhjet e mesmandatit në 20 vjetët e fundit.

Miliona amerikanë kanë votuar në këto zgjedhje, të cilat janë mbajtur në nëntor.

Në garë ishin të gjitha 435 vendet në Dhomën e Përfaqësuesve të ShBA-së si dhe 35 vende në Senatin amerikan dhe 36 për guvernatorë.

Zgjedhet presidenti i Zvicrës për vitin 2023

Prishtinë, 7 dhjetor - Drejtori i "Zërit Perëndimor të Kosovës", Sali Bislimi, ishte i ftuar në parlamentin zviceran për ta përcjellë nga afër zgjedhjen e presidentit për vitin 2023 dhe dy këshilltarëve federalë në Parlamentin e Zvicrës.

Alain Berset ka marrë mandatin e presidentit të Zvicrës për vitin 2023.

Presidenti i Zvicrës zgjedhet çdo vit me rotacion.

Veprimtari Bislimi në kuadër të kësaj ftese ka takuar edhe shumë personalitete të larta të

Zvicrës, deputetë të parlamentit, ku temë diskutimi ishte Kosova, Gjykata Speciale dhe paraburgimi i ish-presidentit Hashim Thaçi. "I ftuar në parlamentin zviceran në ditën e madhe për t'i përcjell punimet nga afër në zgjedhjen e presidentit dhe dy këshilltarëve federalë. Një moment i mirë për të lobuar për Kosovën dhe për presidentin Thaçi, është nder dhe kënaqësi kur të zgjedhurit janë edhe miq të mi", ka shkruar Bislimi në "Facebook".



Gjermania zoton 37 milionë euro për ta përafuar Kosovën me BE-në

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Me përfundimin e negociatave ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Gjermanisë për bashkëpunim zhvillimor, pala gjermane është zotuar se do ta vazhdojë mbështetjen financiare ndaj Kosovës në vlerë prej 37 milionë eurosh për periudhën 2022-2023.

Me këtë zotim, mbështetja gjermane për bashkëpunim zhvillimor arrin shumën prej 64.42 milionë eurosh që nga dhjetori 2020, kur edhe janë mbajtur negociatat e fundit qeveritare.

Duke u pajtuar për shtim të mëtejshëm të bashkëpunimit zhvillimor, Kosova dhe Gjermania do t'i adresojnë së bashku sfidat kryesore të së ardhmes.

Prioritetet e bashkëpunimit zhvillimor përfshijnë: zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, trajnimin dhe punësimin, ndryshimet klimatike dhe energjinë, tranzicionin e drejtë dhe qeverisjen e mirë.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, u shpreh se sot të dyja vendet tona po hapin një kapitull të ri të partneritetit të palëkundur për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane dhe Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. "Me këtë ne mbështesim Kosovën në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian", ka thënë Rohde.

Marrëveshja e bashkëpunimit Gjermani - Kosovë synon nxitjen e aftësimin profesional dhe arsimor si dhe krijimin e vendeve të reja të punës si bazë për

zhvillimin ekonomik të Kosovës. Theksi i veçantë u është kushtuar edhe investimeve të mëtejme në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren (ITP), si projekti kryesor i bashkëpunimit zhvillimor gjermano-kosovar.

Në lidhje me politikën energjetike, sektori publik dhe privat, si dhe shoqëria civile, do të marrin mbështetje në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2022-2031 dhe Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP).

Gjithashtu, fonde të konsiderueshme do të ndahen përmes investimeve në infrastrukturën e ujërave të zeza, duke synuar mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe lumenjve të rrezikuar.

Kjo kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët e Kosovës. Mbështetja e mëtejshme për

proceset e reformës së integritimit në BE do të jetë një tjetër prioritet i bashkëpunimit zhvillimor, me vëmendje të veçantë në fushat e financave publike, hetimit tatimor, drejtësisë dhe zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka falënderuar të dy delegacionet dhe theksoi se "Gjermania ka qenë dhe vazhdon të jetë mbështetëse e vazhdueshme e zhvillimit tonë për më shumë se 20 vjet. Ne kemi ndarë vlera të përbashkëta që nga fillimi dhe mbështetemi në mbështetjen e Gjermanisë drejt realizimit të aspiratave tona për të zhvilluar më tej Kosovën dhe për ta ndihmuar vendin drejt anëtarësimit në BE".

Gjermania është ndër donatorët më të mëdha dypalëshe në Kosovë.

Me angazhimet e reja të ndërmarra, Gjermania dhe Kosova vazhdojnë 23 vjet bashkëpunimin e suksesshëm zhvillimor gjermano-kosovar.

Që nga fillimi i bashkëpunimit zhvillimor gjermano-kosovar në vitin 1999, qeveria gjermane ka ndarë 753.1 milionë euro për rindërtimin dhe zhvillimin e vendit. Objektivi kryesor i bashkëpunimit zhvillimor të Gjermanisë me Kosovën është afrimi i saj me Bashkimin Evropian përmes projekteve me ndikim në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, tranzicionit dhe efikasitetit të energjisë, përmirësimit të infrastrukturës së menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbeturinave dhe forcimit të qeverisjes së mirë. Për më tepër, zgjerimi i kapaciteteve të energjisë diellore në të ardhmen e afër do të jetë një tjetër objektivi prioritar.

Kuvendi për nëntë muaj shpenzoi mbi 4.6 milionë euro për paga e mëditje

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka bërë me dije se shpenzimet e Kuvendit për nëntëmuajorin e këtij viti kapin shifrën mbi 5 milionë euro ose 55 për qind të buxhetit të përgjithshëm.

Në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, Krasniqi ka treguar se për paga dhe shtesa janë shpenzuar 67 për qind e buxhetit ose më shumë se 4.6 milionë euro. "Shpenzimet për

nëntëmuajorin e vitit 2022 për katër programet e lartcekura janë: 5 409 389 92 euro, ose 55.92 për qind e buxhetit vjetor dhe atë si vijon: paga dhe shtesa shuma prej 4 677 839 euro ose 67.73 për qind e buxhetit vjetor, mallra dhe shërbime 589 662 25 euro ose 32.45 e buxhetit vjetor, shpenzime komunale 130 898 19 euro ose 65.45 për qind e buxhetit vjetor, subvencionet dhe transferet 9 780 44 ose 13.97 për qind e buxhetit

vjetor dhe shpenzimet kapitale 1 210 ose 0.18 për qind e buxhetit vjetor. Aktualisht jemi në pritje të raportit të Komisionit të pranimit për projektin 'Krijimi i Qendrës së të Dhënave' me një pagesë rreth 150 000 euro, ndërsa projekti i pajisjeve të sallës plenare do të deklarohet si kursim dhe se do të jetë e nevojshme që të buxhetohet edhe në vitin e ardhshëm", ka thënë Krasniqi.





INCIDENTE NË VERI GJATË PËRGATITJEVE PËR ZGJEDHJE

Ambasadori Hovenier: Nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve në veri

Disa grupe të qytetarëve serbë në Zubin Potok dhe Mitrovicë të Veriut penguan të martën hapjen e zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shkaktuar edhe incidente, por pa pasoja në njerëz. Në këto dy komuna, ashtu si edhe në Zvečan dhe Leposaviq, pritet të mbahen zgjedhjet për kryetarë më 18 dhjetor. Kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka theksuar se incidentet në veri dëshmuar se qasja e KQZ-së është e kufizuar në këtë pjesë të vendit. Ndërkaq ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka pohuar se nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve në veri, duke theksuar se siguria e të gjithë qytetarëve të Kosovës duhet të jetë prioriteti më i lartë

thirrje të gjithë të përfshirëve për përmbajtje.

Ndërkaq më 25 dhjetor do të mbahen zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe Leposaviqit.

Komunat në veri të Kosovës janë pa kryetarë qysh në fillim të nëntorit. Ata dhanë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj një vendimi të Qeverisë së Kosovës për t'i riregjistruar makinat me targa ilegale serbe në veri.

Bazuar në Ligjin për Zgjedhjet, presidentja e Kosovës, Vjosa

Osmani, shpalli më pas 18 dhjetorin datë për mbajtjen e zgjedhjeve atje.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila mbështetet nga Beogradi zyrtar dhe ka udhëhequr komunat në veri, i kundërshton këto zgjedhje. Shefi i EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, dhe ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, kanë thënë se janë të shqetësuar për situatën në veri të vendit.

Wigemark ka shkruar në "Twitter" se është i shqetësuar me incidentet e djeshme në veri dhe se "çdo protestë duhet të jetë paqësore dhe të gjithë duhet të qëndrojnë të qetë dhe të përmbajtur".

Ai ka thënë se EULEX-i do të vazhdojë ta monitorojë situatën në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka shpërndarë postimin e Wigemarkut në "Twitter" dhe ka shkruar "vërtet shumë shqetësuese", duke shtuar që ai mbështetë protestat paqësore, por duhet të ketë "zero tolerancë ndaj dhunës". "Dhuna e djeshme ndaj zyrave të komisioneve komunale zgjedhore është e papranueshme", ka thënë Rohde.

**Kryetari i KQZ-së:
Me zor nuk mbahen
zgjedhjet në veri**

Kryetari i Komisionit Qendror të

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vlerësuar se aktualisht nuk ka kushte për mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të katër komunave në veri (Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq) më 18 dhjetor.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se siguria e të gjithë qytetarëve të Kosovës "duhet të jetë prioriteti më i lartë". "Shtetet e Bashkuara janë të shqetësuar se nuk janë krijuar kushtet për momentin që zgjedhjet të mbahen në fund të këtij muaji në veri të Kosovës. Siguria e të gjithë qytetarëve të Kosovës duhet të jetë prioriteti më i lartë. Ne kërkojmë që të tregojnë vetëpërmbajtje. Kthimi kah dhuna dhe frikësimi, përfshirë përdorimin e një mjeti shpërthyes, dhe rrezikimi i jetëve, nuk janë kurrë metoda të përshtatshme proteste, në asnjë rrethanë", ka shkruar Hovenier

në "Twitter".

Komentet vijnë një ditë pasi grupe të qytetarëve serbë në veri penguan hapjen e zyrave të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, duke shkaktuar edhe incidente me armë zjarri dhe granata.

Hovenier ka thënë se ShBA-ja i dënon këto akte dhe u bëri



Guvernatori i BQK-së: Kontributet pensionale duhet të shfrytëzohen pas pensionimit

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Anëtarët e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere kanë diskutuar të mërkurën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondet Pensionale. Për të dhënë mendim më të qartë për këtë çështje, komisioni ka ftuar përfaqësues nga Banka Qendrore dhe nga Trusti Pensional.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se qëllimi i kontributeve pensionale është që të ofrojë mirëqenie pas moshës së pensionimit. Sipas tij, këto mjete duhet të shfrytëzohen pas pensionimit në mënyrë që këta persona të mos bëhen barrë e shtetit. "Konsideroj se mjetet pensionale si qëllim kryesor është që të sigurojnë mirëqenie për qytetarët pas pensionimit, që të kenë një mirëqenie e mos të bëhen barrë sociale e shtetit", tha Mehmeti.

Mendim të njëjtë dhe kundër tërheqjes së mjeteve nga Trusti shprehu edhe Ruzhdi Morina, kryesues i Bordit të Trustit Pensional.

Drejtori i Trustit, Adrian Zalli, ka



thënë se nëse Projektligji kalon në Kuvend, rreth 600 milionë euro do të tërhiqen. "Nëse shkohet siç

është propozuar në ligj, shumica që do të tërhiqet është mbi 594 milionë euro, pra nëse të gjithë i

tërheqin mjetet. Nëse marrim për bazë praktikën se sa i kanë tërhequr herën e kaluar është 95

për qind. Andaj është e pritshme që e njëjta të tërhiqet, pra rreth 600 milionë euro", ka thënë Zalli.

LV-ja për qeverisjen e Përparim Ramës: Një vit me kaos

Prishtinë, 7 dhjetor - Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Guxo kanë mbajtur të mërkurën aktivitet në sheshin "Nënë Tereza", duke vendosur 12 pano për 12 muaj të qeverisjes së Përparim Ramës si kryetar i kryeqytetit.

Drejtuuesi i Grupit të Këshilltarëve Komunalë të Lëvizjes Vetëvendosje, Gëzim Sveçla, ka thënë se kryetari Rama është në realizimin më të ulët të premtimeve të veta dhe se ndërhyrjet e tij janë vetëm kozmetike. Ai listoi dëmet kryesore që i ka bërë qeverisja e LDK-së dhe e PDK-së në komunën e Prishtinës. "Ka ndodhur kapje klasike e

ndërmarrjeve publike komunale. Po ndodhin punësime të militantëve partiakë të LDK-së dhe të PDK-së në këto ndërmarrje dhe nëpër dikastere e drejtori të ndryshme. Po shpërblehen me kontrata njerëz të afërt me partitë në pushtet. Është duke u abuzuar me buxhetin komunal me lloj-lloj konsulencia milionëshe, të dyshimta e të panevojshme, siç është rasti me tenderin 12 milionësh. Janë duke u bërë marrëveshje të dëmshme për interesin qytetar, me operatorë të ndryshëm ekonomikë, siç është rasti me rritjen e jashtëligjshme të tarifave të parkingut nëntokësor. Pra po

bëhet gjithçka për partitë dhe për miqtë e tyre, por nuk po bëhet asgjë për qytetin e për qytetarin", ka thënë Sveçla. Këshilltarja komunale nga Partia Guxo, Triera Kasumi-Berisha, ka thënë se Prishtinës i duhet një ritëm më i madh të cilën, fatkeqësisht, pushteti aktual nuk e ka. "Nuk do të hezitohet të përkrahim projekte të mira, nëse do të ketë të tilla, por nuk zbrapsem nga konsistenca për ligjshmëri. Vlen të theksohet se nga arroganca e tyre shumë vendime që ka marrë Kuvendi i Komunës së Prishtinës janë shpallur të paligjshme", ka thënë Kasumi-Berisha.



Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka theksuar se incidentet në veri më 6 dhjetor dëshmuar se qasja e KQZ-së është e kufizuar në këtë pjesë të vendit. Në Zubin Potok dhe Mitrovicë të Veriut, Policia e Kosovës konfirmoi se ka pasur "shpërthime dhe shkrepe armësh".

Zyrtarët komunalë zgjedhorë, që ishin nën përcjelljen e Policisë së Kosovës, u tha se u penguan që të shkonin në zyrat komunale zgjedhore në këto dy komuna për t'i kryer detyrat e tyre zyrtare.

Gjatë një mbledhjeje të KQZ-së pasditen e 6 dhjetorit, Radoniqi ka theksuar se pret ta shohë raportin e sigurisë për procesin zgjedhor të Policisë së Kosovës, duke shtuar se "me zor nuk mbahen zgjedhjet në këtë formë". Sipas tij, KQZ-ja nuk

mund ta rrezikojë jetën e zyrtarëve zgjedhorë. "Sot kishim planifikuar t'i vizitojmë zyrat tona për të parë se a kemi qasje. Çfarë është e evidente nga raporti dhe nga çka u pa në medie është pak problematike që të kemi qasje në zyrat tona", ka thënë ai.

Radoniqi shtoi se më pas raporti i policisë do t'i dërgohet edhe zyrës së presidentes së bashku me kërkesat e KQZ-së për të ofruar siguri për zyrtarët zgjedhorë. Megjithatë, ai nuk u pajtua me anëtarët e komisionit, që kërkuar prani më të madhe të policisë, duke theksuar se "nëse duam të shkojmë me tërë aparat policorë, të armatosur deri në dhëmbë, atëherë çfarë zgjedhje duam të organizojmë".

Disa anëtarë të KQZ-së kërkuar

që zyrtarëve zgjedhorë t'u ofrohet siguri më e madhe dhe disa kërkuar që Bashkimi Evropian t'ia tërheqë vërejtjen Serbisë, që t'i largojë grupet që, sipas tyre, qëndrojnë pas incidenteve. "Në këto kushte nuk mund të punojmë sipas planit tonë të paraparë. Është e padrejtë të kërkohej nga zyrtarët tanë që të dërgohen në një vend ku ka pasiguri", ka thënë Radoniqi.

Kurti: Bandave kriminale në veri po u vjen fundi

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se me shtimin e sulmeve në veri që, sipas tij, po kryhen nga "banda kriminale" të cilat "paguhen dhe dirigojnë nga Serbia", do të ketë edhe shtim të

pranisë policore në këtë pjesë të shtetit. "Bandat kriminale kanë intensifikuar sulmet në veri të Kosovës. Ato e dinë se po ju vije fundi. Qeveria e Kosovës as s'bën pazare me to dhe as s'i duron ato. Bombat që hedhin, plumbat që shkrepin dhe maskat që vendosin janë pafuqia e tyre politike e popullore. Me këto krime e sulme të armatosura në veri të Ibrit, doemos do të kemi më shumë polici të Kosovës atje. Sepse do të ketë hetime e ndjekje të këtyre kriminelëve, që paguhen nga Serbia e dirigojnë nga presidenti i saj. Shkeljet e shumta të ligjit nuk do të falen kurse tendencat për destabilizim kriminal do të dështojnë. Në katër komuna në veri nuk është ndarja në serbë e shqiptarë, por në banda

kriminale dhe qytetarë. Kërkoj nga të gjithë qytetarët e Kosovës që të mbështesin shtetin dhe policinë e Kosovës, të gjithë zyrtarët tanë që po mbrojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, republikën dhe demokracinë", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Për incidentet e së martës në veri, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, bëri përgjegjëse, siç tha, "bandat kriminale", të përkrahura politikisht dhe financiarisht nga [presidenti i Serbisë, Aleksandar] Vuçiq. "Ne duhet të bëjmë çmos që nëpërmjet institucioneve të sigurisë të Kosovës, të vendosim rend dhe ligj në çdo cep të vendit tonë, por edhe ta mbrojmë jetën e secilit qytetar, pavarësisht etnisë", ka theksuar Osmani.

UNË, STUDENT POLITIK I MAO CE DUNIT, ZAJEBNICA NUK KALON!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Zgjedhjet në veri të Kosovës dhe Hamami i Hyrës: Në veri të Kosovës është një anarki jashtëzakonisht e organizuar mirë dhe e menaxhuar nga Aleksandër Vuçiq, Zot i Veriut dhe pronar i vullnetit politik të serbëve të Kosovës. E gjithë kjo bëhet me përkrahjen e heshtur të bashkësisë ndërkombëtare e cila Serbinë e konsideron si partnere, ndërsa Kosovën si vartëse. Vuçiqi, të cilin po e shajnë gjithë ditën, po i shkojnë në shtrat natën. E luajti lojën me targa ilegale dhe me dorëheqjen e serbëve nga institucionet e Kosovës në veri duke kërcënuar se i njëjti skenar mund të përdoret edhe në pjesët e tjera të Kosovës ku jetojnë serbët. Në të njëjtën kohë kryeministri Kurti po i

viziton muzetë e famshme botërore, së fundi edhe Muzeun Prado në Madrid ku u mbajti ligjëratë spanjollëve për artin dhe kulturën spanjolle. Dhe kujt, një ish-politikani, tani në një gjendje të hibernacionit (gjumit), mendor, Havier Solanës. I ka mbetur vetëm edhe të shkojë dhe ta bëjë një përmirësim, përkatësisht ta mohojë se Pablo Pikaso është autor i Guernikes në kohën kur autori i vërtetë është kryeministri ynë artistik! Nuk e kam të ditur nëse e ka vizituar Muzeun e famshëm botëror të antikuiteteve si është Skala në Milano, Shtëpinë e famshme Operistike Luvr në Paris, pstatat e famshme botërore ku mbahen garat e Formulës 1 në

Koloseum të Romës apo shtigjet për gara të hipizmit (gara me kuaj) në Monca. Apo amfiteatrin ku ligjërohet për Kantin, Sokratin dhe Platonin në Las Vegas apo Atlantic City. Sikur edhe Shtëpinë e njohur për bixhoz në Metropolitan të Nju-Jorkut. Po në këtë kohë Vuçiqi punonte dhe konsolidonte ushtrimin e pushtetit në veri të Kosovës. Si shtet i fuqishëm që jemi, me një qeveri që kurrë dhe nëse ekziston edhe si terminologji gjuhësore, në fjalorin e veprimit të qeverisë nuk ekziston sepse Zajebnica nuk kalon. Kjo është qëndrësë, këto janë parime

ndonëse ka mungesë kronike të koçeve!
Institucionet tona janë jashtëzakonisht të përkushtuara për integrimin e serbëve dhe duhet të pranohet se kanë sukses të plotë, në vend të qindra dhe mijëra serbëve “të Vuçiqit” që u larguan nga puna integruan dy serbë “të Albinit”, Nenad Rashiç dhe Radmilla Trajkoviç. Rashiçi, me njohuritë gjuhësore të gjuhës shqipe, mund të punojë si lektor për përmirësimin e teksteve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe politikanëve kosovarë, kurse Rada Trajkoviçi mund t’ia mprehë lapsin Rashiçit gjatë korrigjimit të teksteve. Ne si shtet serioz dhe me sovranitet

të plotë që e kemi, menjëherë i organizuam zgjedhjet në veri të Kosovës dhe i certifikuam kandidatët. Dikush hodhi disa bomba e që për ne nuk paraqesin asnjë shqetësim për faktin se, edhe ashtu jemi në fund të vitit dhe duhet të kontribuojmë për krijimin e një atmosfere festive. Së fundi, për zgjedhjet në veri u deklarua anëtari i KQZ-së. Zoti Hovenier me një shqetësim të vogël: “sa keq që në veri nuk u krijuan kushtet për mbajtje të zgjedhjeve...”. Megjithatë, fjalën kryesore do ta ketë kryetari i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, zoti Gabriell (Xhebrail) Eskobar, ditën e hënë. Gojëkëqijte po flasin se këtë do ta kundërshtojë me vendosmëri nacionalisti i madh shqiptar

Komuna e Prizrenit po vazhdon shpërndarjen e mekanizmave bujqësorë për fermerët

PRIZREN, 7 DHJETOR - “Investimi i komunës së Prizrenit në mekanizëm bujqësor është faktor që mbështet rritjen e nivelit të punës dhe është mjeti më efikas për zbatimin e kërkesave bujqësore për fermerët e komunës sonë, gjë që rritë cilësinë e prodhimeve bujqësore dhe ul koston prodhuese”, ka

thënë nënkryetari i komunës, Kujtim Gashi, me rastin e shpërndarjes së mekanizmave bujqësorë për fermerët. I pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Bexhat Bytyçi, ku u bë shpërndarja e 50 multikultivatorëve me frezë dhe 5 freza me gjatësi

1.6 metra për fermerët përfitues në projektin “Furnizim me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim”. Kjo është faza e dytë e ndarjes së mekanizmave bujqësorë, ndërsa projekti vazhdon së zbatuari sipas afateve ligjore për fermerët e tjerë përfitues në kuadër të këtij procesi të subvencionimit.



dhe luftëtari i palakueshëm për bashkim me Shqipërinë, Alim Rama! Jam në ethe dhe po brengosem shumë për z. Hovenier dhe Eskobar kur të përballen me Alimin! Kryeministri Kurti deklaroi se për shkak të seriozitetit të situatës do të dërgohen forca të shtuara policore në veri. Lexova diku se në opinion po qarkullon një udhëzues për Njësinë Speciale me këtë përmbajtje: “Gjatë rrugës për në veri të Kosovës, mos këndonin këngë patriotike se na qihet nëna ...”. Ministri: Filan Fisteku:

Samiti në Tiranë: Edhe këtu Vuçiqi ua luajti lojën praktikantëve në politikë. Si shenjë “kundërshtimi” ndaj vendimeve të kryeministrit Kurti i futi në një thes Kurtin, Trajkoviçkën dhe Nenad Rashiqin duke deklaruar se nuk do të marrë pjesë në Samitin e Tiranës. Një ditë para Samitit pati një takim me rrencin e certifikuar të BE-së, Miroslav Lajçak i cili, kinse e luti të marrë pjesë në Samit. Po në të njëjtën kohë, burri më i fortë në Qeverinë e Serbisë, Ana Bërnabiq, doli me një sugjerim që Vuçiqi duhet të marrë pjesë në këtë Samit duke i siguruar alibi dalës nga premtimi i “fortë” se nuk do të marrë pjesë në këtë Samit. Në fund, deklaratën e përbashkët me marrëveshjet e dakorduara nuk u nënshkrua vetëm nga Aleksandër Vuçiqi për faktin se ishte një votim se të gjitha shtetet nënshkruese detyrohen t’i fusin sanksionet ekonomike dhe të tjera Rusisë dhe ai këtë nuk e bën. Cilat ishin “pasojat” për Serbinë dhe favorret për Kosovën? Jua rikujtoj lexues të nderuar, se Kosova ndonëse askush nuk e kërkoi nga ne, ishte vendi që i pari ia futi sanksionet Rusisë, duke e dëmtuar jashtëzakonisht shumë ekonominë ruse, që nga bllokimi i tregjeve financiare, asetëve materiale, mallrave të ndryshëm e deri tek embargo për armët bërthamore dhe furnizim me dronë që Rusia i kërkonte nga Kosova, duke mos pyetur për çmimin që duhet paguar. Kosova, si furnizuesja më e madhe në botë me gaz rus dhe naftën e papërfunduar, e para ndërpreu të gjitha kontratat

duke i falimentuar rafineritë e shumta në Kosovë. Krejt falë meritës, syçeltësisë dhe largpamësisë së kryeministrit Kurti, presidentes Vojsa Osmani dhe mashtruesit shëtitës, Besnik Muçiverces. Madje, në planin politik, as Kombet e Bashkuara dhe BE-ja nuk e kanë dëmtuar më shumë politikën ruse se trojka e lartpërmendur kosovare. Prodhues të pordhëve, me mbushje atomike! Ndërkaq Serbia u dënua shumë rëndë me vazhdimin e përdorimit të targave ilegale, mospagesën e rrymës elektrike dhe shërbimeve të tjera, pagat për 100 e më shumë serbë që kurrë nuk kanë punuar as edhe një minutë të vetme, shndërrimin e institucioneve të Kosovës në Bahçe të Babës, kur iu çohet dalin nga to, kur duan kthehen në to, me jetësimin e Zajebnicës, me federalizimin e Kosovës dhe, së fundi, me një dokument në formë të propozimit franko-gjerman, ku ka Zajebnicë, por nuk ka njohje në kohën kur njohja parashihet të ndodhë në njërin nga dhjetëvjeçarët e ardhshëm për faktin se, me zhvillimin e shkencës, do të arrihet që shelqja të bëjë rrush. Atëherë do të kemi njohje reciproke. Për politikanë që e duan shtetin, edhe pa bashkim kombëtar që, në asnjë mënyrë nuk e lejon Kushtetuta e Kosovës, propozimi franko-gjerman përmes riciklimit të letrës së këtij propozimi do të fitohej një letër tualeti e përshtatshme për prapanicën e Mirrosllav Lajçakut. Këta tanët po thonë që është bazë e mirë që, pas një kohe, kur të bëjë shelqja rrush, Kosova të afrohet me Serbinë duke shtyrë njohjen reciproke për ndonjë dhjetëvjetësh tjetër. Çfarë mashtrimi andaj nuk e bëjnë publik, deri të na fusin kepën! Sa të pamoralshëm dhe sa të panjerëzishëm!

Granit Xhaka dhe xhakalinjtë e tjerë: Dueli midis Serbisë dhe Zvicrës në futboll u shndërrua në luftë politike, vazhdim i luftës midis dhunuesit - Serbisë dhe viktimës - Kosovës që përfaqësoheshin nga Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Ardon Jashari, që bartnin fanellën e reprezentacionit të

Zvicrës. Ishte krijuar një trysni e madhe psikologjike. Zvicra fitoi dhe, edhe një betejë mbaroi me fitoren e shqiptarëve. Granit Xhaka, djali i vogël i Ragip Xhakës, shkëlqeu, bashkë me Xherdanin. Gjatë lojës, Granit Xhaka demonstroi njohuri të mira nga anatomia duke bërë përpjekje që këtë njohuri ta bartë te studentët serbë të Vojisllav Sheshelit që, tërë kohën, bashkë me absolventin e Sheshelit, trajnerin e Serbisë, në vend që të luanin futboll, merrshin me nënat shqiptare thuaja se po iu duken pak se gjatë luftës së fundit kanë dhunuar 20 000 nëna, motra, vajza, gra, madje edhe të moshuara shqiptare! Kriminelë ishin, kriminelë janë dhe kriminelë mbesin. Pas reagimit të Xhakës, nga qarqe të fuqishme “intelektuale”, me kredibilitet moral dhe ndikim të madh në vetëdijen e injorantëve, ky veprim u cilësua si rrugaçëri, ndërsa pati edhe asi (v) lladika që deklarorin se Granit Xhaka nuk e ka lexuar as edhe një libër të vetme duke injoruar faktin se Granit Xhaka e ka lexuar Enciklopedinë e Jetës shkruar mbi vuajtjet, viktimat dhe luftës shekullore të shqiptarëve për Liri, Çlirim dhe Bashkim - Kombëtar! Identifikuesit e rrugaçërisë nuk e njohin këtë Enciklopedi Jetësore të cilën me krenari e lexon Granit Xhaka për faktin se prindërit e tyre ose familjarët e tyre nuk kanë pshurrë gjak, në vend të shurrës nga torturat e këtyre dhe paraardhësve të cilëve Graniti ua tregoi aletin. Këta nuk kanë asnjë rast që familjarët e tyre kanë dalë pa dhëmbë, pa sy, pa veshkë dhe, ndoshta, edhe pa mend nga torturat e këtyre me të cilët u përballë Granit Xhaka. Fëmijët e të ish-burgosurve politikë shqiptarë në ish-Jugosllavi janë rritur pa prindër, të cilët, nëse kanë pasur fat, i kanë takuar në moshë të një burri ndërsa, në jo pak raste, asnjëherë nuk i kanë takuar. Këta janë rritur me ëndrrat se si duket prindi i tyre, babai ose nëna, pa gjëra elementare të jetës dhe historia e tyre është historia e prindërve të tyre dhe atyre që luftuan për liri të cilën këta, pameritueshëm, e gëzojnë

duke e shpërdoruar atë. Granit Xhaka është biri i Ragip Xhakës e jo i Rrahman Morinës. Granit Xhaka e ka trashëguar një krenari gjenetike nga babai i tij dhe axha i tij, po çka kanë trashëguar sharësit e tij përveç privilegjeve materiale dhe turpit për faktin se paraardhësit e tyre kanë kontribuar në burgosjen dhe dënimin e Ragip Xhakës dhe të gjithë patriotëve shqiptarë sikur që ishin babai dhe axha i Granit dhe Taulant Xhakës. Çfarë keni pritur të reagojë ndryshe Granit Xhaka në atë situatë?! Të thirret në trashëgimin “kombëtare” dhe politike të Ali Shukrisë, Sinan Hasanit, Kolë Shirokës, Sejdo Bajramoviqit, Selim Broshës, Gazmend Maliqit, Sahit Ismailit, Rrahman Morinës, Buba Morinës, Slobodan Millosheviqit dhe Vojisllav Sheshelit! Gjaku nuk bëhet ujë! Granit Xhaka ka me çka të krenohet, sharësit e tij kanë me çka të turpërohen! Granit Xhaka u kritikua pse e barti fanellën me mbiemrin Jashari duke aluduar në mbiemrin e Komandantit Legjendar Adem Jashari nga i cili, përveç se distancohen, për shkak të rikthimit të vëllazërim-bashkimit, edhe ndihen të turpëruar! Edhe çifti i tyre e gëzojnë lirinë, nëse e konsiderojnë këtë liri, si liri! Po ta bartte Granit Xhaka një fanellë me mbiemrin e Rrahman Morinës, cili do të ishte reagimi, ju të pandjenja dhe të paprovuar me atë që ka kaluar Ragip Xhaka dhe të gjithë ragipët në burgjet e ish-Jugosllavisë, në krye me Kuptimin, Inspiruesin dhe Përmbajtjen e Luftës për Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar, të Pavdekshmin, Bacë Adem Demaçi! Ju që keni dalë nga kotilla e ish-Jugosllavisë dhe Serbisë nuk e kuptoni këtë. Më është bërë shumë qejfi që Maroko e nxori nga loja Spanjën e që është thuaja një histori e ngjashme sikur ajo e Kosovës me Serbinë. Katalonasi që e kundërshton egërsisht pavarësinë e Katalonjës, Rrahman Morina i Katalonjës, dhe dhunuesi i pavarësisë së Kosovës, Joseph Borrell, sigurisht se ndihet i pikëlluar për këtë eliminim. Asgjë nuk

mbetet pa u paguar në këtë botë!

Gënjeshtare kronike, jo vetëm në politikë: Një valltare ekzotike e Humanistit të Madh dhe Aktivistit për të Drejtat e Njeriut, Moamer el Gadafi, në shenjë respekti dhe kujtimi për njërin nga padronët e shumtë, bëri vizitë në Gjykatën Raciste Speciale për ta vizituar patriotin Rexhep Selimi. Është për çdo admirim kjo sakrificë e saj. Veprim edhe më të mirë bëri kur nuk pranoi t’i vizitojë tradhtarët si Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Nasim Haradinaj, Hysni Gucati, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala të cilët, çuditërisht, ishin në po të njëjtin burg me Rexhën, të akuzuar për të njëjtën vepër, si udhëheqës ushtarakë dhe politikë të Ushtrisë së Lavdishme Çlirimtare të Kosovës dhe posteve më të larta shtetërore, me një fjalë që luftuan, bashkë me Rexhën, për këtë liri që Vallëzueses së Gadafit gjithmonë i siguroi një grazhd për të mos mbetur e uritur dhe për të pushuar! Vallëzueset ekzotike kanë luajtur rol vendimtar gjatë disa proceseve historike siç ishte puna e Mata Harit që, për arritjen e qëllimeve, vetëm e luante rolin e vallëzueses ekzotike, ndonëse nuk ishte se merre shumë vesh nga ky vallëzim.

Po kjo Mata Hari e Kosovës që ka dy fytyra, njërin e vallëzuese ekzotike, pra Mata Hari dhe tjetra si predikuese politike (fetare) sikur që e bënte Sekti Hari Krishna! E pabesueshme deri ku mbërrin urrejtja dhe mosdurimi ndaj atyre që e kanë ushqyer me poste dhe të tjera!

Studenti politik i Adem Demaçit dhe studenti politik i Vojisllav Sheshelit: Kohën e fundit, në mungesë të veprimit dhe guximit politik, qarkullonin informata se Albin Kurti edhe vetë ka deklaruar se është student politik i Adem Demaçit, kurse Aleksandër Vuçiqi është student politik i Vojisllav Sheshelit. Për një gjë jam shumë i sigurt: Aleksandër Vuçiq ka qenë student politik i Vojisllav Sheshelit. Pikë. Adem Demaçi i ka pasur koç... e elefantit. Pikë.

Biblioteka “Fan S. Noli” në Gjilan pasurohet me libra të rinj

GJILAN, 7 DHJETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se Bibliotekën “Fan S. Noli” e kanë pasuruar me libra të rinj në vlerë prej 10 mijë eurosh. “Pas digjitalizimit të bibliotekës së qytetit, lexuesit, me skanimin e një barcodi, mund të marrin titujt e librave që ndodhen në fondin e bibliotekës dhe shërbimet e

tjera të nevojshme. Tani atë e pasuroam me libra të rinj në vlerë prej 10 mijë eurosh për sektorin shkencor, atë të rriturve dhe të fëmijëve”, ka thënë kreu i Gjilanit. Për më tepër, kryetari Hyseni është shprehur se nga afër panë edhe funksionimin e sistemit elektronik të menaxhimit të lexuesve, si biblioteka e parë në nivel

vendi që kaloi nga regjistrimi manual në atë digjital. “E kemi zotim dhe obligim institucional investimin në zhvillimin e kushteve të nevojshme për ta lehtësuar qasjen në literaturë digjitale dhe tërhequr vëmendjen drejt librit si burim i pazëvendësueshëm i dijes”, ka deklaruar kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni.



Kriza energjetike, ekspertët kërkojnë të analizohet mundësia e prodhimit të gazit nga linjiti

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest", në bashkëpunim me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), ka organizuar debatin për çështjen e gazit në Kosovë në kontekst të orientimeve strategjike në sektorin e energjisë.

Alban Hashani, drejtor ekzekutiv i Institutit "Riinvest", tha se në korrik të këtij viti ligjvënësit e Bashkimit Evropian në mbështetje të propozimit nga Komisioni Evropian kanë vendosur që gazi natyror të konsiderohet burim i gjelbër dhe i qëndrueshëm i energjisë. Prandaj, sipas tij, në rrethanat kur sistemit energjetik të Kosovës i nevojitet fleksibilitetit më i madh, diskutimet lidhur me zhvillimin e rrjetit të gazit si dhe mundësisë së prodhimit të gazit nga linjiti, nuk kanë marrë vëmendjen meritore.

Ai më tej shtoi se në draft-strategjinë për energjinë nuk ka detaje të hollësishme për këtë çështje vetëm se përmendet studimi i fizibilitetit me Maqedoninë e Veriut. "Në draft-strategjinë e energjisë theksohet se opsionet për ndërtimin e një sistemi me bazë gazi natyror në Kosovë janë duke u analizuar në Master Planin e Gazit dhe në studimin e fizibilitetit për tubacionin e interkoneksionit të gazit në



mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, pa u dhënë detaje më të hollësishme. Për më tepër, në draft-strategji nuk diskutohet fare mundësia e prodhimit të gazit nga linjiti në Kosovë", ka thënë ai.

Luan Shllaku, drejtor ekzekutiv i "KFOS", tha se me përdorimin e gazit do të mundësohej përmirësimi i parametrevë ambientalë jo vetëm në vend, por edhe ata globalë. Sipas tij, qeveria e ka të qartë se edhe rajoni po përballet me krizë energjetike, prandaj edhe duhet ta marrë seriozisht furnizimin me gaz, ngaqë e ka edhe obligim. "Ne e kemi ftuar këtë tryezë të bisedojmë për

gazin e cila është temë botërore. Me të madhe është biseduar si do t'ia bëjmë këtë dimër. Kemi folur për qymyrin dhe kemi evituar të flasim për diçka që si t'i projektojmë zhvillimet energjetike në Kosovë. Ishte nevoja të mendohet më ndryshe për energjetikë. Me përdorimin e gazit do t'i përmirësojmë shumë parametra ambientalë, globalë", ka thënë Shllaku.

Geri Selenica, drejtor ekzekutiv nga Qendra Shqiptare e Studimeve Strategjike, tha se Kosova është e treta sa i përket ndotjes nga qymyri pas Polonisë dhe Gjermanisë, prandaj edhe duhet të

fokuset në alternativa të tjera.

Sabit Restelica, konsulent për çështje mjedisore, tha se cilësia e linjtit është shumë e ulët, duke shtuar se me anë të teknologjisë mund të ketë avancime. "Cilësia e linjtit është shumë e ulët dhe përbërja e hirit nuk është e favorshme për prodhimin energjetik. Teknologjia ka avancuar shumë. Hulumtimet për teknologji të reja kanë arritur rezultate të mira", ka pohuar ai, duke shtuar se linjtin duhet ta zhvillojmë me teknologjinë më të avancuar. Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest", në

bashkëpunim me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), kanë lansuar platformën Green Action Space, e cila përmban aktivitete kërkimore, arsimore dhe avokuse për të kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve tek aktorët e ndryshëm dhe për avancimin e politikave që ndërlidhen me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Në kuadër të kësaj platforme janë paraparë një seri debatesh "GREEN TALKS" lidhur me çështjet vitale që ndërlidhen me Agjendën e Gjelbër si një prioritet në rrugën e integritimit në Bashkimin Evropian.

Kurti: Rasti i mjedrave është një nga shembujt e potencialit tonë eksportues



PRISHTINË, 7 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në Konferencën e 7 të Mjadrës në Kosovë "Mjedra - iniciativat e reja për ndryshimet klimatike".

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri Kurti tha se këtë vit kanë dhënë mbështetjen më të madhe ndonjëherë për bujqit dhe për fermerët, duke theksuar se vitin e ardhshëm buxheti për bujqësi do të jetë më i lartë. "Gjatë këtij viti kemi dhënë mbështetjen më të madhe ndonjëherë për bujqit dhe për fermerët. Krahas mbështetjes prej 70 milionë eurosh, subvencionimit të kulturave të shumta bujqësore, në mesin e tyre edhe të mjedrës - për 25 % më shumë sesa në vitin pararendës, këtë vit kishim ndarë edhe 3.5 milionë euro për zhvillimin dhe promovimin e turizmit rural dhe të agroturizmit. Ndërkaq, sipas planifikimeve të buxhetit për vitin 2023, që tashmë ka kaluar në lexim të parë, buxheti për bujqësi parashihet të jetë 87 milionë euro, ndërkaq kur ta përfshijmë edhe mbështetjen nga fondet e

jashtme, ai pritet që për herë të parë në Kosovë ta kalojë shumën prej 100 milionë eurosh", u shpreh kryeministri Kurti.

Në tetë vjetët e fundit, pra nga viti 2014 deri në 2022, Kosova ka prodhuar afër 29 000 tonë mjedrë, në vlerë prej 65 milionë eurosh, pothuajse e tëra për eksport për në vendet e BE-së, ndërkaq që vetëm këtë vit u prodhuan afro 2 600 tonë mjedrë me një vlerë të eksportit prej 11 milionë eurosh apo saktësisht 11 milionë e 50 euro.

Kryeministri Kurti ka thënë se rasti i mjedrave është një nga shembujt e potencialit tonë eksportues. "Nuk ka dyshim që vendi ynë po bëhet vend i orientuar për nga eksporti", ka deklaruar ai. Kurti ka thënë se qeveria është e përkushtuar që t'i mbështesë dhe zbatojë standardet më të mira të mundshme për përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit, krijimin e vendeve të punës e kushte më të mira të punës, rritjes së eksportit, sigurimin e ushqimit të bollshëm e të sigurt dhe përmirësimin e gjallërimit e peizazhit agro-rural.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës si masë e aftësive reflektive për bërje



Prof. dr. Arben HOXHA

Hyrje

Liria nuk është aftësi; ajo është kushti i të gjitha aftësive. Si aftësi, ajo është cilësi e gjësë; si kusht i të gjitha aftësive, ajo është qenia e gjësë. Është kjo arsyeja se pse Hajdegeri në ontologjinë fundamentale të tij do të konsiderojë se nuk është njeriu ai që e zotëron lirinë, është liria ajo që e zotëron njeriun. Liria shkon përtej kufijve të njohjes logjike dhe është kushti i saj. Luftëtari i lirisë jodomosdoshmërisht duhet t'i ketë të lexuar filozofët apo shkrimtarët që kanë shkruar për lirinë. Adem Jasharit nuk i janë dashur t'i lexojë Platonin, Homerin, Eskillin, Spinozën, Kantin, Hegelin, Sartrin, Poperin etj. si parakusht për ta materializuar aktin e vet të flijimit për liri. Pasioni i intuitës për t'iu përgjigjur thirrjes për ndihmë rrënjëve të fijeve të barit të atdheut të kërcënuar nga shkelja e çizmes së huaj e tejkalon çdo përfytyrim të arsyeshmërisë njerëzore që i përcakton kufijtë e të mundshmes dhe të pamundshmes. Pa këtë pasion as ideja e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) nuk do të mund të ekzistonte, e aq më pak do të mund të flitej për aktualizimin e saj.

Liria, si pasion i intuitës, është përfaqësim i drejtpërdrejtshmërisë së qëndrueshmërisë që ka një person në bindjen për rolin e vet në bërjen e gjërave në botë. Ndërkaq, liria si vlerë përcaktohet nga afërsitë

e vetëdijes aksiologjizuese për të zgjedhur atë që është e rëndësishme në procesin e bërjes, e kjo do të thotë për kapërcimin kualitativ nga një shkallë më e ulët në një shkallë më të lartë të bërjes së ekzistencës. Historikisht vështruar, filozofia e vlerës së lirisë – siç thotë Sartri – si themel i të gjitha vlerave, është zhvilluar paralelisht me shfaqjen e një shqetësimi dominues për qëllimet njerëzore në rrugën e zgjerimit të kufijve të ekzistencës së njerëzimit. Vetëm përmes vetëdijes aksiologjizuese, liria si vlerë, mund të ngrihet në një realitet promodial, mbi bazën e të cilit mund të kuptohet dhe të ndërtohet tërësia e ekzistencës njerëzore.

Në kushtet e pushtimi klasik të regjimit gjenocidal të Millosheviqit, shprehur me terma të Hajdegerit, liria do ta zgjedhë subjektin e realizimit të vetes – UÇK-në dhe vetë ekzistenca e UÇK-së do të jetë e ndërlidhur nga përcaktimi i saj për ta zgjedhur vlerën e lirisë. Pa UÇK-në, si subjekt i lirisë, nuk ekziston vlera e lirisë. Sartri thotë se jashtë angazhimit të subjektit që i zgjedh vlerat, vlerat nuk ekzistojnë. Është subjekti UÇK ai që do ta sjellë vlerën e lirës në ekzistencë, për t'u shndërruar vetë në subjekt me vlerë. Rrjedhimisht, mund të themi se vetë ekzistenca e subjekti të UÇK-së që e ka sjellë vlerën e lirisë në ekzistencë është një vlerë që duhet të njihet nga të gjithë.

Pikëpamja aksiologjizuese utilitariste

Pyetja që shtrohet sot është se lufta

e UÇK-së nga të qenit subjekt i lirisë a ka arritur që të shndërrohet në përmbajtje të vetëdijes sonë aksiologjike, si përcaktuese e qëllimeve tona kombëtare për bërje?

Nga zgjedhja që kemi bërë për mënyrën e (ri)varrimit të dëshmorëve të UÇK-së menjëherë pas luftës; me qëndrimin tonë ndaj memorialit të Kullava të Jasharëve tash e 23 vjet, nga mënyra e satanizimit të ushtarëve të UÇK-së në mediet tona para e pas luftës; prej hartimit të Ligjit të Veteranëve të Luftës së UÇK-së (çështja aq shumë e përfolur e Listës së Veteranëve të luftës së UÇK-së është treguesi i përmasës së sëmundjes shpërfytyruese të marrëdhënies sonë me idenë e lirisë dhe rregullimi i Listës së saktë të Veteranëve nuk mund të arrihet asnjëherë pa shërimin moral të kësaj marrëdhënieje!); prej mënyrës së hartimit të Kushtetutës së Kosovës, e cila luftën e UÇK-së nuk e përmban si premisë juridiko-politike të shtetësisë së Kosovës dhe nga mënyra e themelimit të Gjykatës Speciale nga Kuvendi i Kosovës, mund të konkludohet se UÇK-ja, në radhë të parë, nga shqiptarët, më pas edhe nga ndërkombëtarët, është parë si një vlerë që buron nga pikëpamja e aksiologjisë utilitariste, e cila llogarit në interesin praktik (e edhe material) tash dhe këtu, në njërin anë, brenda forcave politike shqiptare në luftën për pushtet ndërsa, nga ana tjetër, në rrafshin e politikave ndërkombëtare, si vlerë për ekuilibrim forcash në

shoqërinë botërore. Në të dyja rastet, më parë sesa një e mirë e dëshirueshme si qëllim, UÇK-ja do të perceptohet një e mirë e dëshirueshme si mjet.

Në qoftë se Gjyqi i Nurembergut do të jetë pasqyrim i sistemit të drejtësisë mbi të cilën do të funksionojë rendi i ri botëror pas Luftës së Dytë Botërore, Gjykata Speciale, si pjesë e sistemit të drejtësisë ndërkombëtare, do ta pasqyrojë krizën e sistemit të rendit botëror në këtë fillim të mileniumit të ri. Në rastin e Gjykatës Speciale, përkundërt Gjykatës së Nurembergut, e drejta pozitive do të mbetet pa përmbajtjen e të drejtës morale. Ndërsa Gjykata e Nurembergut do të jetë produkt i sistemit të drejtësisë, i cili do ta menaxhojë “rendin botëror” të pas Luftës së Dytë Botërore, Gjykata Speciale do të jetë produkt i sistemit të drejtësisë ndërkombëtare në kontekstin e botës gjeopolitike të “ekuilibrit botëror”, si mishërim i raportit dinamik midis forcave kundërshtuese në një sistem të hapur. Nëse rendi është statik, ekuilibri është dinamik, thotë teoricieni i politikës Saul Cohen. Karakteri dinamik që buron nga përplasia e forcave të kundërta, për ta ruajtur ekuilibrin global, “flijon” agentë të ndryshëm që ka në dispozicion (edhe përbërës të së drejtës ndërkombëtare, edhe elementë të vlerës së lirisë!) në funksion të stabilitetit, si tipar i ekuilibrit global. Në kontekstin e “rendit botëror” të pas Luftës së Dytë Botërore (dhe jo vetëm) do të ishte e pamundur të imaginohej

një “Nuremberg” kundër hebrejve. Në kontekstin e “ekuilibrit botëror”, në emër të “pastrimit” të një lufte çlirimtare, me lehtësi të papërbalueshme për asnjë fuqi imagjinatë bëhet realitet ekzistenca e Gjykatës Speciale për krimet e supozuara të UÇK-së. Gjykata e Nurembergut ishte produkt i forcave aleate fituese të Luftës së Dytë Botërore; Gjykata Speciale është produkt i nevojave për stabilitetin e ekuilibrit midis forcave të superfuqive botërore konkurruese në luftën për zgjerimin e zonave të tyre të interesit.

Sistemi i drejtësisë ndërkombëtare, i fillimit të mileniumit të tretë, do të jetë shfaqja e thelbit të parimit të ekuilibrit global. Gjykata Speciale është simptoma e mungesës së “rendit” të shoqërisë botërore. Gjykata Speciale në Hagë do të bazohet në moralin universal të të drejtave të njeriut, si një instancë juridike supernacionale me aspiratën për arrijtjen e një harmonie planetare duke u bazuar në aspiratat empirike të natyrës njerëzore (Jean-Jacques Wunenburger). Në rastin e Gjykatës Speciale të Hagës, universaliteti i moralit të të drejtave të njeriut do të jetë kërcënim serioz i të drejtës së popujve për liri. Gjykata e Nurembergut me moralin e të drejtës kolektive, si një entitet konkret historik, do të vihet në funksion të lirisë, sigurisë dhe mirëqenies së njerëzimit. Duke u bazuar në të drejtën pozitive dhe duke e përjashtuar prej saj çfarëdo lloj mundësie implikimi të së



drejtës morale në të, Gjykata Speciale në Hagë do ta trajtojë barabarësisht si pushtuesin ashtu edhe të pushtuarin; si ushtruesin e genocidit ashtu edhe atë që ka pësuar nga genocidi.

Lufta kundër vlerës së UÇK-së si luftë kundër rendit botëror

Agresionit ushtarak rus në Krime e Ukrainë i ka paraprirë agresioni diplomatik rus e serb për kontestimin e sistemit të drejtësisë ndërkombëtare përmes kontestimit të karakterit të drejtë të luftës së UÇK-së. Themelimi i Gjykatës Speciale nuk është çështje e testimit të qëndrueshmërisë së vlerës së UÇK-së, por testim i qëndrueshmërisë së rendit botëror, i qëndrueshmërisë së besimit në sistemin e drejtësisë ndërkombëtare, i cili shfaqet përmes trajtimit juridik të së drejtës së një lufte anticoloniale, siç ishte lufta e UÇK-së.

Themelimi i Gjykatës Speciale është finalizimi i agresionit që Serbia, në bashkëpunim me Rusinë, do të bëjë, në njërin anë, mbi hapësirën e boshatisur të vetëdijes aksiologjizuese shqiptare për lirinë, si vlerë supreme dhe, nga ana tjetër, mbi arealin e vetëdijes aksiologjizuese utilitariste perëndimore.

Si?

Duke përdorur hapësirat e boshatisura që ekzistojnë ndërmjet vlerës universale të moralit të drejtave të njeriut dhe vlerës "partikulare" të moralit të së

drejtës kolektive të popujve për liri në sistemin e së drejtës ndërkombëtare penale. Kontradikta midis vlerës së një kriteri abstrakt universal e jashtëkohor (të drejtave të njeriut) dhe vlerës së një kriteri konkret në histori (lirisë së popujve të veçantë), në rastin e Gjykatës Speciale do të tejkalohet përmes përqafimit të vlerës së parë duke e përjashtuar nga logjika e drejtësisë vlerën e kriterit të dytë. Gjykata Speciale do ta bëjë një zhvendosje thelbësore të vëmendjes nga trajtimi i tërësishtëm i njeriut si qenie e lirë dhe si vlerë të dimensionit i njeriut si person fizik dhe juridik. Për rrjedhojë, shprehur me terma të Toma Akuinit, kriteri i drejtësisë së sjelljes do t'i mbivendoset kriterit të drejtësisë së kauzës. Në këtë mënyrë logjika e drejtësisë do të pezullohet nga koncepti i luftës së drejtë dhe luftës së padrejtë. Për rrjedhojë Gjykata Speciale Kosovën do ta kthejë nga një çështje e historisë së dekolonizimit në çështje të të drejtave të njeriut. Ndërsa presioni i bashkësisë ndërkombëtare kundrejt deputetëve të Kuvendit të Kosovës për domosdoshmërinë e themelimit të Gjykatës, do të jetë tregues i krizës së vetëdijes aksiologjizuese perëndimore në kontekstin gjeopolitik të ekuilibrit global (vetëm konteksti gjeopolitik i ekuilibrit global e bën të kuptueshëm presionin që ShBA-ja do të ushtrojë mbi establishmentin politik të Kosovës për ta votuar themelimin e Gjykatës Speciale) aprovimi i Gjykatës Speciale nga deputetët e Kuvendit

të Kosovës, do të jetë treguesi i kapaciteteve të ulëta të vetëdijes aksiologjike shqiptare për vetëbërje. Në të vërtetë, do të jetë tregues i aftësive të munguara krijuese përballë qëllimit për kapërcim nga modusi i ekzistencës së mbijetesës në modusin e ekzistencës për bërje. Prej një përmbysjeje të tillë të logjikës së të drejtës dhe drejtësisë, Serbia do të synojë ta ndërtojë narracionin e vet moral se:

– intervenimi i NATO-s ka qenë një gabim;

– se në Kosovë, si pjesë jugore e Serbisë, nuk ka pasur luftë mes ushtrisë së Serbisë dhe UÇK-së, porse aty ka ndodhur një luftë civile për pushtet midis UÇK-së terroriste dhe partive paqësore e minoriteteve etnike të pambrojtura;

– se ushtria e policia serbe kanë ndërhyrë me qëllim që ta parandalojnë dhe ta pamundësojnë këtë luftë civile, por intervenimi i NATO-s ia ka pamundësuar këtë duke marrë një vendim të gabueshëm për largimin e babës (Serbisë) nga shtëpia (Kosova) (Rezoluta 1244), në vend se të dëbohet "fëmija problematik" (UÇK-ja);

– NATO padrejtësisht e detyroi "babën" (lexo Serbinë administrative, ushtarake e policore) të dëbohet nga shtëpia, duke e ndarë atë edhe nga "fëmijët e vet të mirë". Ekzistenca e Gjykatës Speciale është provë e mjaftueshme që baba (Serbia) tashmë duhet të kthehet në shtëpinë e vet pranë "fëmijëve të vet të mirë" në Kosovë.

Me pak fjalë, ky është narracioni

që, përmes Gjykatës Speciale, Serbia do të përpiqet ta rrisë vëllimin e argumentit për "të drejtën morale" të kthimit të saj në Kosovë. Ndërkaq, brenda Kosovës subjektet konkurrenente politike, duke përfituar nga goditja që do ta marrë "krahu i luftës" prej Gjykatës Speciale, do të përpiqen të krijojnë "avantazhe morale" për rolin e tyre në historinë më të re të "çlirimit" dhe të "shtetndërtimit" të Kosovës. Mjerim! Kaq është pika e lartësisë ku mund të arrijë steka e interesave mesquine të vetëdijes tribaliste shqiptare!

Përfundim

Mbrojtja e vlerës së lirisë përmes instrumenteve të sistemit të drejtësisë (lokale apo ndërkombëtare) duhet të jetë shprehje e fuqisë motivuese për rritjen e jetës dhe sigurisë së ekzistencës së shoqërisë njerëzore në botë. Gjykata Speciale nuk do t'i shërbejë lirisë dhe mirëqenies së njerëzimit, sepse është mekanizëm për ruajtjen e baraspeshave të forcave mes shtetesh në një rend botëror të luhatshtëm nga paqëndrueshmëria e sistemit të vet të drejtësisë. Presioni për themelimin e Gjykatës Speciale nga ndërkombëtarët drejtuar kuvendarëve të Kosovës, është prova që vërteton se liria e një populli, në vend të rritjes së sigurisë së lirisë së njerëzimit, mund të përdoret si mjet për harmonizimin maksimalist të interesave kundërthënëse në kontekstin gjeopolitik të "ekuilibrit botëror".

Për shkak se vlera e lirisë është e

ndërlidhur me motivimin, sepse vetëm përmes motivimit vlera merr kuptim, Kuvendi i Kosovës, me aktin e aprovimit të Ligjit për Dhomat e Specializuara, ka vendosur standardin moral të ndarjes së vlerës nga motivimi. Me votimin pro themelimit të Gjykatës Speciale, Kuvendi i Kosovës, popujve që bëjnë lufta anticoloniale gjithandej botës, ashtu sikurse edhe pasardhësve tanë, u ka dërguar mesazhin dekurajues e antihistorik se liria në përgjithësi, dhe liria e tyre në veçanti, nuk përfaqëson ndonjë interes me rëndësi për zhvillimin dhe emancipimin e llojit njerëzor në botë; se liria nuk është çështje e vullnetit dhe e së drejtës morale të subjekteve të veçanta, por çështje nomenklaturash dhe raporte forcash.

Qëndrimi i tillë ndaj UÇK-së është tregues i mungesës së parimeve të filozofisë së vlerave dhe të vetëdijes sonë të kufizuar aksiologjike në rrugën e bërjes subjekt në histori.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

Çështja e Kosovës dhe roli i diplomacisë ndërkombëtare në procesin e çlirimit të saj

Prof. dr. Lulëzim LAJÇI

Pas Luftës së Dytë Botërore, me dominimin politik serb, çështja e Kosovës u tentua të mbyllej në mënyrë të panatyrshme dhe të kurdisur politikisht. Deri në vitin 1981 shteti jugosllav kishte arritur ta mbante Kosovën jashtë fokusit të informacionit ndërkombëtar.

Demonstratat e vitit 1968, me kërkesën e tyre për Republikën e Kosovës, u paraqitën para opinionit ndërkombëtar si protesta të zakonshme studentësh për përmirësimin e kushteve ekonomike të jetës. Ndërsa shqiptarët e dënuar për veprimtari patriotike konsideroheshin të "burgosur politikë", po si një dukuri e zakonshme – e natyrshme për të gjithë Jugosllavinë dhe vendet e tjera të bllokut lindor.

Mirëpo, duke filluar nga demonstratat e viti 1981, kur shqiptarët ripërsëritën kërkesën për Republikën e Kosovës, e ku u vranë 9 sipas burimeve jugosllave, ndërsa 300 veta, sipas burimeve amerikane, çështja e Kosovës shpërtheu kornizat jugosllave dhe u bë objekt i shtypit dhe i medieve ndërkombëtare të kohës, por jo edhe i qeverive të shteteve të veçanta apo i organizimave politike ndërkombëtare.

Pra, qeveritë e ndryshme dhe përgjithësisht faktori ndërkombëtar mospërkrahjen ndaj demonstratave të vitit 1981 e manifestoi me heshtje. Federata jugosllave përfaqësonte si për Lindjen ashtu edhe për Perëndimin një hapësirë të veçantë, ku takoheshin e ekuilibroheshin interesat dhe koniunktura e kompromisit të tyre. Për Perëndimin Jugosllavia ishte zonë e erozionit të ndikimit rus, kurse për Lindjen ishte një model i socializmit human në botë. Të dyja palët preferonin ta kishin një shtet jugosllav të vetëm dhe të mos hapnin dritë jeshile për lëvizjet e tjera kombëtare jo vetëm në Jugosllavi, por edhe në Ballkan dhe në Evropë. Prandaj, shtetet evropiane e injoruan me mospërfillje çështjen e Kosovës.

Pas demonstratave të vitit 1981, statusi shoqëror-politik e juridik i shqiptarëve dhe i vetë Krahinës së Kosovës erdhi duke u minimizuar. Ky fenomen u bë i dukshëm pas ardhjes së Millosheviqit në pushtet si president i Serbisë (1985), i cili u mbështet në forcat konservatore e nacionaliste serbe. I inkurajuar nga heshija e Evropës dhe e republikave të tjera jugosllave ndaj problemit të Kosovës, si dhe për ta rritur autoritetin e tij politik, S. Millosheviqi luajti me kartën nacionale, duke e sensibilizuar opinionin serb për pozitën e pafavorshme kushtetuese territoriale, ekonomike e shoqërore të Republikës së Serbisë në Federatën Jugosllave.[1]

Në rrjedhën e kësaj politike, më 23 mars të vitit 1989, nën gjendje të jashtëzakonshme, nën mbikëqyrjen e më shumë se 16 mijë ushtarëve dhe 10 mijë policëve specialë të policisë federale, në seancën e Kuvendit të Kosovës u aprovuan amendamentet në Kushtetutën e Serbisë. Seanca "solemne", dy herë e

shtyrë, u mbajt më 23 mars dhe në të, pos "shumicës së delegatëve" (siç vlerësoi pa u numëruar, kryetari i Kuvendit Vukashin Jokanović, megjithëse as sot nuk dihet numri i saktë i delegatëve të pranishëm) ishin të pranishëm edhe politikanë kosovarë dhe nga Serbia e federata, nga APJ-ja sikur edhe një numër i bollshëm i "delegatëve" nga DB-a (Drzhavna Bezbednost: Sigurimi Shtetëror), të cilët kishin votuar në emër të delegatëve dhe për hir të atmosferës? Në këtë seancë, pasi që disa delegatë kërkuar të diskutoheshin (u fol rreth tri orë e gjysmë) kryetari i Kuvendit, Jokanović, më së miri shprehu karakterin "demokratik" dhe "juridik" të kësaj seance, duke thënë: "Këtu është çdo gjë e qartë si kristali dhe s'ka për çfarë të debatohet". Një qëndrim të avancuar mbajti Melihate Termkolli, e cila publikisht nuk u pajtua me amendamentet në Kushtetutën e Serbisë, sepse "edhe formalisht krahina e humbi autonominë", si dhe Riza Lluka, i cili kërkoi që të votojnë vetëm delegatët dhe jo edhe "të tjerët" si dhe të konstatohet numri i delegatëve të pranishëm dhe i atyre që votojnë për dhe kundër. Për t'u aprovuar amendamentet për është dashur të votojnë 126 delegatë, pra dy të tretat e delegatëve të pranishëm. Në këtë akt të rrënimt të konstitucionit të Kosovës fatkeqësisht morën pjesë edhe rreth 100 delegatë të zgjedhur shqiptarë, me çka formalisht e legjitimuan farsën e dytë në historinë më të re, që luhej me votën e përfaqësuesve të popullit shqiptar dhe për këtë historia nuk fal.[2] Me këtë akt u rrëzuan të gjitha strukturat institucionale, politike, ekonomike, gjyqësore, policore, shëndetësore e kulturore autonome të Kosovës dhe gjithçka u vu nën pushtetin e Beogradit.

Dhuna antikushtetuese që ndërmori pushteti serb ndaj strukturave autonome të Kosovës dhe masat represive ndaj popullsisë shqiptare, e përqësuan situatën dhe i bënë shqiptarët më të vendosur në rrugën drejt shkëputjes. Më 2 korrik 1990, si përgjigje ndaj politikës rrënuese të Beogradit, të 114 deputetë shqiptarë të Kosovës, miratuan Deklaratën Kushtetuese, përmes së cilës de jure Kosova shkëputej nga Serbia dhe linte të hapur mundësinë e participimit në Federatën apo Konfederatën Jugosllave, si element konstituiu i së cilës ishte edhe sipas Kushtetutës së vitit 1974, por kjo lirie varësisht se si do të përcaktoheshin edhe popujt e tjerë të saj. Shpallja e pavarësisë së Kosovës u bë në një kohë kur ende nuk ishte shkatërruar Federata Jugosllave dhe kur Kosova rrezikohesh të bëhej Serbi. Ky ishte edhe hapi më logjik që mund të ndërmerrej.[3] Meqenëse punimet e seancës së Kuvendit të Kosovës në sallën e parlamentit i pengoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, sërish një serb, Bozhović, seanca i zhvilloi punimet në platenë përpara Kuvendit. Deklaratën e lexoi Bujar Gjurjealo, ndërsa arsyetimin Muharrem Shabani.

Në kuptimin konstitucional Rezoluta e Bujanit është analoge me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut



1990, e cila në substancë ishte shprehje e vullnetit politik të popullsisë shumicë në Kosovë për vetëvendosje:

"Deklarata Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të Federatës / Konfederatës së Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në Federatë / Konfederatë". Lidhur me këtë akademik Gazmend Zajmi shkruante: "Me këtë Deklaratë Kushtetuese, me karakter konstituiu politik, përveç të tjerash, 'ipso jure' u bë derogimi i rezolutës së Kuvendit të Prizrenit të vitit 1945 mbi bashkimin e Kosovës 'Serbisë federale' (Leges posteriors priores contrairas abrogant).[4] Kështu, çështja e Kosovës, pas shpalljes së Republikës së Kosovës, hyn në një fazë të re historike, në rrugën e arritjes përfundimtare të pavarësisë së Kosovës – zgjidhje me peshë madhore e çështjes shqiptare në përgjithësi dhe me peshë ndëretnike ballkanike.[5]

Pas këtij hapi, një delegacion i Kuvendit, i përbërë nga Muharrem Shabani, Bujar Gjurjealo dhe Skënder Skënderi, që ditën vijuese pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese, ishte nisur jashtë Kosovës, në mënyrë që të vendosnin kontakte me autoritetet e porsazgjedhura slovene dhe kroate si dhe me qeveritë e vendeve evropiane dhe me atë amerikane, me qëllim që t'i shpjegonin kushtet dhe rrethanat në kuadër të cilave Kuvendi i Kosovës kishte nxjerrë Deklaratën Kushtetuese dhe mundësisht ta siguronin përkrahjen e tyre.

Pas kësaj pritej se çfarë kundërmasash do të ndërmermin Serbia dhe Jugosllavia. Kjo pritej nuk zgjati shumë. Kuvendi i Serbisë më 5 korrik në procedurë të parregullt dhe pa mbështetje kushtetuese nxori vendimin mbi suspendimin e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës dhe vendosjen e administrimit të dhunshëm në Kosovë. Të njëjtën ditë me forca policore nga ndërtesa e Kuvendit u dëbuan të gjithë zyrtarët e lartë e punonjësit e Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës. U ndërpre me forcë emetimi i programit të Radiotelevizionit të Prishtinës dhe, pas disa ditësh, edhe gazetës së përditshme "Rilindja" iu bë i pamundur botimi. Në ditët që pasuan nga puna u larguan me dhunë të gjithë të punësuarit në administratën qendrore, numri më i madh i pjesëtarëve shqiptarë të policisë si dhe filloi largimi nga puna i të punësuarve në administratën lokale. Më nuk kishte dyshim se Serbia po vendoste një aparat të

okupimit klasik në Kosovë dhe se ajo dëshironte ta sundonte atë si një koloni të saj.

Ndaj këtyre masave të dhunshme të Serbisë faktori shqiptar, i prirë nga partitë e reja politike, që vepronin atëherë, më e madhja ishte LDK-ja si dhe nga Sindikata e Pavarur e Kosovës, filloi të riorganizohet dhe mënyrën e veprimit e rezistencës t'u përshtatë kushteve dhe rrethanave të reja, të cilat i kishte imponuar Serbia. Shumë manifestime, demonstrata dhe forma të reja të rezistencës linin të kuptoheshin se populli i Kosovës s'do të nënshtrohej dhe se do ta kundërshtonte okupimin e Kosovës nga Serbia. Ky ishte një mesazh i fuqishëm që çdo ditë u dërgohej forcave okupuese serbe në Kosovë dhe faktorit të jashtëm. Shteti shqiptar me një Deklaratë të Kuvendit të Shqipërisë njohu Republikën e Kosovës. Ky qëndrim i Kuvendit të Shqipërisë nuk ishte obligues dhe nuk kishte domethënie e hapjes së mundësisë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Ishte ky më shumë një akt politik i Tiranës zyrtarë për t'i inkurajuar shqiptarët e Kosovës. Në fakt, qysh atëherë u kuptua se Shqipëria nuk ka potenciale reale politike dhe ushtarake për ta ndihmuar Kosovën në rast të shpërthimit të luftës edhe në Kosovë.[6] Mirëpo, në anën tjetër, bashkësia evropiane dhe shtetet e tjera të Perëndimit, posaçërisht ShBA-ja, zhvilloi kontakte të shumta politike me udhëheqjen e Kosovës dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë. Përfaqësuesit e shqiptarëve u pritën nga zyrtarët e këtyre shteteve deri në nivelet më të larta shtetërore. Delegacione të shumta qeveritare, parlamentare e humanitare që e vizituan Kosovën, u dhanë përkrahje kërkesave të shqiptarëve dhe e përshëndetën organizimin politik e shtetëror shqiptar. Këto shtete, po ashtu, nxorën shumë rezoluta, në parlamentet kombëtare e të Bashkimit Evropian, në të cilat dënohej dhuna e pushtetit serb në Kosovë dhe përkrahej çështja shqiptare.[7]

Në këto rrethana organet shtetërore të Kosovës bënë përpjekje për ta riorganizuar mënyrën e veprimit dhe përshtatjen e organizimit të veprimtarisë sipas situatës së krijuar. Kuvendi i Kosovës ishte në një gjendje edhe më specifike në këto kushte. Ai kishte një obligim të veçantë që dilte nga pika 5 e Deklaratës Kushtetuese. Ai duhej ta përgatiste dhe ta shpallte Kushtetutën e Republikës së Kosovës me aktet e tjera të

nevojshme që nxirreshin në rast të tilla. Kjo e vinte në pozitë të tillë Kuvendin që duhej të organizohej në atë mënyrë që kjo punë të bëhej sa më shpejt dhe sa më mirë. Pothuajse çdo ditë gjatë korrikut dhe gushtit delegatët vinin në Prishtinë, mbledheshin nëpër vende të ndryshme dhe bisedë të vetme kishin si dhe kur të mbahet mbledhja, në të cilën do të shpallej Kushtetuta. Te ta kishte një gatishmëri të jashtëzakonshme dhe mund të thuhet një padurim, shkruan Iljaz Ramajli, që kjo punë të bëhej sa më shpejt, pa marrë parasysh pasojat.[8]

Më 7 shtator 1990 çdo gjë funksiononte në mënyrë perfekte, vazhdon Iljaz Ramajli. Delegatët arritën në Kaçanik në kohën e caktuar, u pritën sipas planit, mbledhja filloi në orën 8 (në mbrëmje), ashtu siç ishte planifikuar dhe përfundoi pa pengesa. Kuvendi në këtë mbledhje shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe aktet e tjera përcjellëse, duke e çuar Kosovën në një etapë të drejt ecjes në rrugën për pavarësi dhe krijim të shtetit sovran.[9]

Pra, ligjëvënësit shqiptarë miratuan një Kushtetutë, e cila shpalli që:

"Republika e Kosovës është shtet demokratik i popullit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve dhe minoriteteve me qytetarët e saj: serbët, myslimanët, malazetët, kroatët, turqit, romët dhe të tjerët që jetojnë në Kosovë... Republika e Kosovës si një shtet është pjesë e komunitetit jugosllav".

Në anën tjetër Beogradi u përgjigj duke e quajtur deklaratën e Kaçanikut si një akt jokushtetues dhe një sulm direkt ndaj integritetit të Serbisë dhe të Jugosllavisë. Autoritetet jugosllave arrestuan disa anëtarë të Kuvendit të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër u largua në Kroaci, në Sloveni ose jashtë shtetit për t'i shpëtuar arrestimit.[10]

Kështu konform vendimeve të 2 korrikut dhe në prag të shkatërrimit të Federatës Jugosllave (pasi gjërat në konstitucionin jugosllav u qartësuan politikisht dhe juridikisht), nga e cila po dilnin shtetet sovrahe, si Slovenia, Kroacia, BH-ja, Maqedonia u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Deklarata Kushtetuese dhe Kushtetuta e Kaçanikut janë aktet më të larta konstitucionale të Kosovës, pas Rezolutës së Bujanit, me çka de jure filloi ndërtimi konstitucional i Kosovës nga përfaqësuesit e popullit.

Ndërkohë agresiviteti i pushtetit serb vazhdoi të rritej. Për rrjedhojë një vit më vonë, më 26-30 shtator 1991, në Kosovë u organizua Referendumi[11] për t'ia dhënë Republikës së Kosovës legjitimitetin e nevojshëm. Tani jo brenda Federatës Jugosllave, por shtet sovran dhe i pavarur. Ky referendum përfundoi me sukses të plotë dhe ishte sanksionim i së drejtës së vetëvendosjes së popullit shqiptar në kushtet e reja të pluralizmit. Republika e Kosovës ishte alternativë e mbijetesës. Kështu, çështja e Kosovës, pas shpalljes së Republikës së Kosovës, hyn në një fazë të re historike, në rrugën e

arritjes përfundimtare të pavarësisë së saj. Zgjidhje kjo me peshë madhore të çështjes shqiptare në përgjithësi dhe peshë ndëretnike në Ballkan.[12]

çështja shqiptare, si një çështje unike e pazgjidhur e familjes së popujve evropiane, në kushtet e shkatërrimit të Federatës Jugosllave dhe të shpalljes së pavarësisë – Republikës së Kosovës, do të bëhet shqetësim jo vetëm për kombin shqiptar, por edhe për shtetet evropiane e sidomos për ShBA-në.[13]

Karta e legjitimitetit të deputetëve të Kuvendit të Parë Demokratik të Kosovës, të dalë nga zgjedhjet e 24 majit 1992 në Kosovë, u dogj pa u konsistuar kurrë ky kuvend. U bë një përpjekje që Kuvendi të mblidhet, porse forcat serbe rrethuan medresenë "Alaudin" të Prishtinës, ku ishte paraparë mbajtja e seancës konstituive të Parlamentit të Kosovës. Në Parlamentin e parë shumëpartiak në Republikën e Kosovës ishin zgjedhur 130 deputetë, prej 22 partive, grupeve dhe shoqatave politike e jopolitike. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) pati fituar 547 755 vota apo 76.44 për qind të elektoratit, ndërsa e dyta ishte Partia Parlamentare që kishte fituar 36 549 vota apo 4.86 për qind të elektoratit. Prej 130 deputetëve të zgjedhur në votime të drejtpërdrejta dhe në proporcionale, 96 deputetë ishin të LDK-së, 13 të Partisë Parlamentare, 7 të Partisë Fshatare, 7 të Partisë Shqiptare Demokratiane, 2 kandidatë të pavarur, 5 deputetë nga Partia e Aksionit Demokratik të Kosovës (myslimanë), ndërkaq ishin rezervuar 14 vende për deputetët serbë dhe malazezë (sipas proporcioneve). Meqë Kuvendi i parë u zgjodh në kohën kur sapo ishin liruar nga burgu shumëvjeçar qindra të burgosur politikë, në mesin e deputetëve të zgjedhur pati mbi 50 deputetë që kishin vuajtur nëpër burgjet serbe.[14]

Në këtë kohë Bashkimi Evropian dhe shtetet e tjera të Perëndimit, posaçërisht ShBA-ja, zhvilluan kontakte të shumta politike me udhëheqjen e Kosovës e udhëheqës të tjerë shqiptarë. Përfaqësuesit e shqiptarëve u pritën nga zyrtarët e këtyre shteteve deri në nivelet më të larta shtetërore. Delegacioneve të shumta qeveritare, parlamentare e humanitare, që e vizituan Kosovën, iu dha përkrahje kërkesave tona, po ashtu u nxorën shumë rezoluta, në parlamentet kombëtare e të komunitetit Evropian, në të cilën dënohej dhuna e pushtetit serb në Kosovë dhe përkrahej çështja shqiptare.[15]

Në anën tjetër, përkundër rrethanave të reja, pushteti qendror në Beograd mëntonte ta ruante hegjemoninë që e kishte vendosur mbi këto republika, sovranitetin e tyre, disa nga ato arritën në luftë (Sllovenia, Kroacia dhe BH-ja), ndërsa Kosova u vendos në një "patpozicion", duke e anashkaluar në Dejtton.[16]

Shtetet perëndimore në fillim përpjekshin që në Kosovë të mos shpërthente konflikti i armatosur dhe të zbutet represioni serb, i cili kishte për qëllim ndryshimin e strukturës së popullsisë në Kosovë me anë të spastrimit etnik. Me qëllim që ky konflikt latent të evitohet deri në zgjidhjen definitive të çështjes së Kosovës, kryetari i Republikës së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, parashtrijoi një plan veprimi prej 10 pikash, ndër të tjera, kërkoi që



Kosova të vihej nën protektoratin e OKB-së dhe të ndërmerren masat e duhura në pajtim me këtë akt. Këtë plan të Rugovës e mbështeti edhe Republika e Shqipërisë.[17] Pikërisht në momentet kur çështja e Kosovës u bë shqetësim për nivelet e veçanta e të përbashkëta ndërkombëtare, kur një konfiguracion i ri etnik e politik u krijua në territorin e ish-Jugosllavisë, sekretari i NATO-s, gjenerali Manfred Verner, paralajmëronte Serbinë kundër përpjekjeve për spastrim etnik të shqiptarëve nga Kosova dhe nënvizonte se "një zgjerim i luftërave drejt Kosovës dhe një luftë ballkanike duhet të ndalet me çdo çmim". Kurse ish-presidenti Xhorxh Bush paralajmëroi udhëheqjen serbe në dhjetor të vitit 1992 që ShBA-ja mund ta përdorë forcën në qoftë se Serbia shtrin luftën në Kosovë. Mesazhi i Bushit indirekt thoshte që "në rast të konfliktit në Kosovë të shkaktuar nga serbët, ShBA-ja do të përgatitet t'i përdorë forcat ushtarake në Kosovë dhe Serbi kundër serbëve".[18]

Një muaj më vonë, përkatësisht më 21 janar 1993, edhe Bil Klintoni në fjalimin e tij të përrurimit për president të ShBA-së, në mënyrë indirekte ia dërgon këtë mesazh Millosheviqit: "Çdo herë që interesat tona kërcënohen, ose kurdoherë që vullneti dhe ndërgjegjja e bashkësisë ndërkombëtare përbuzet, ne do të veprimi me diplomaci paqësore kur është e mundur, me forcë kur është e nevojshme".[19]

Kështu, për herë të parë që nga Lufta e Dytë Botërore, në vitet '90 koncepti humanitar fitoi epërsinë mbi konceptin e "interesave të shtetit", të "integritetit tokësor", të sovranitetit absolut", të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare. Kjo ishte një risi shumë pozitive me rrjedhimet të paparashikuara, por pa dyshim përparimtare dhe e mirëseardhur. Bota e re filloi kështu një epokë, në të cilën gjykimi dhe ndërgjegjja e opinionit ndërkombëtar po konkretizohet me një të drejtë ligjore ndërkombëtare, që inkurajon "veprime të përbashkëta" në "kuadër të OKB-së", kundër "shteteve sovraane" që sfidojnë këtë gjykim dhe ofendojnë këtë ndërgjegje, kundër luftërave civile e eksodit dhe urisë masive, kundër gjenocidit etj. Këto ndodhën kur u shua "bota dyopolare" apo e "dy superfuqive", kur ShBA-ja mbeti e vetnija superfuqi e aftë për të formuar dhe drejtuar koalicionet për përbashkëti dhe situatave ekstreme. Si rrjedhim, me gjithë dëshirën e shumë qeverive të Evropës Perëndimore që ShBA-ja ta luajë rolin e "policit ndërkombëtar", këtë superfuqi koha e "dënoi" që ta marrë përsipër rolin udhëheqës në

krijimin e një rendi të ri botëror. Dy deklaratat e dy presidentëve të ShBA-së, Xhorxh Bush dhe Bil Klinton, dëshmojnë se koncepti i "sovranitetit" do të kalojë në një fazë transitorë për arsye të përparësisë që fiton respekti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos garancia e jetës së lirë. Ky qëndrim inkurajoi popujt e pushtuar-robëruar, pra edhe popullin shqiptar, ta kërkojë me këmbëngulje të drejtën e vetëvendosjes, duke përfshirë edhe pavarësinë e plotë, si mjet i fundit për ndalimin e shkeljes së të drejtave individuale dhe kolektive.

Nga pikëpamja e sigurimit të paqes ndërkombëtare edhe koncepti i mosndërhyrjes në punët e brendshme pësoi ndryshim me rastin e Kosovës, sepse përvoja tregoi se lufta në Kosovë paraqet kërcënim për paqen botërore dhe se imperativi i ruajtjes së paqes imponon si zgjidhje të fundit mundësinë e intervenimit.[20] Rendi i ri botëror imponoi përdorimin e forcës për probleme të reja, siç janë: mbrojtja e një shteti demokratik, mbrojtja e të drejtave të njeriut për grupe të gjera popullore nga shkeljet e rënda, katastrofat njerëzore: si uria masive, anarkia, eksodi i pafund, pastrimi etnik me anë të dhunës, katastrofat humanitare etj. dhe ndalimi i luftës vëllavrasëse shkatërrimtare.[21] ShBA-ja, por edhe Britania e Madhe dhe ato shtete që kanë qenë të interesuara për ta nxjerrë Kosovën pa kaluar nëpër përvojën e Bosnjës, janë munduar vazhdimisht të krijojnë parakushte për këtë. Janë munduar që problemin e Kosovës ta zgjidhin shkallë-shkallë, duke i amortizuar pengesat e shteteve, si: Rusia, Kina etj.[22]

Pas të gjitha këtyre zhvillimeve, është e kuptueshme edhe prania e kontingjentit të forcave të huaja në Maqedoni qysh në vitin 1992. Fillimisht i njohur me emrin "Forcat e UNPROFOR-it". Në përbërje të këtyre forcave ishin dy batalione, të njohura shkurt US-bat (Batalioni amerikan) dhe Nord-bat (Batalioni nordik). Me fillimin e luftës në Kosovë më 1998 institucionet ndërkombëtare dhe shtetet aleate të Paktit të NATO-s e përforcuan praninë e tyre ushtarake në Maqedoni. Në të njëjtën kohë edhe qeveria shqiptare, zyrtarisht kërkonte asistencë ushtarake të huaj, së pari të NATO-s në kuadër të formulës "partneriteti për paqe" (partner ship for peace).

Ekspertët e NATO-s fillimisht propozuan një ndarje joproporcionale të këtyre forcave ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë. U vendosën 18 mijë forca në Maqedoni dhe 2 000 në Shqipëri. Ndërsa rreziku i luftës po

bëhej gjithnjë e më i madh, prania ushtarake ndërkombëtare u shtua pa shumë zhurmë e deklarata.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së dy herë mori në shqyrtim gjendjen në Kosovë dhe diskutoi edhe mundësinë e nevojës së ndërhyrjes. U miratua rezoluta që e dënonte regjimin e Beogradit, por nuk u vendos në favor të ndërhyrjes. Në tetor të vitit 1998 në politikën euroatlantike u shfaq një nismë e re për ndërhyrje ushtarake, nisma e NATO-s. Të 19 vendet anëtare të Aleancës arritën në përfundim kolegjial se "Millosheviq i nje vetëm guhën e forcës".[23]

Duke vlerësuar se rreziku i përhapjes së luftës jashtë kufijve të ish-Jugosllavisë ishte shndërruar tashmë gati në një kërcënim, komanda politike e NATO-s vendosi t'ia drejtojë Beogradit një ultimatum, afati i të cilit skadonte pas dy javësh. Në përfundim të këtij afati do të hynte në fuqi "urdhri i veprimit" (action order). U bë e ditur se urdhrin për veprim do ta jepte J. Solana, nëse Beogradi nuk i tërheq forcat ushtarake nga Kosova dhe nuk e ndal dhunën në Kosovë. Kjo nënkuptonte se në mbarim të afatit të parashikuar në ultimatum nuk do të ishte e nevojshme thirrja e një mbledhje tjetër e anëtarëve të Aleancës.

Mirëpo, ultimatumit i parë i NATO-s "action order" dështoi. Gjatë dy javësh Perëndimi manifestoi pajtim të plotë për ndërhyrje.

Të gjitha vendet anëtare të NATO-s deklarorin se sa forca dhe mjete ishin gati t'i vinin në dispozicion të komandës së operacionit. Mirëpo, natën e përfundimit të afatit, në Beograd gjendej për "bisedime të fundit" ndërmjetesi amerikan Hollbruk. Pikërisht natën e mbarimit të ultimatumit në Itali ndodhi një krizë qeveritare, e cila paralizoje veprimin e Romës dhe e bëri të paqartë mundësinë e shfrytëzimit të bazave të saj. Mirëpo, qeveria italiane u rikrijua me të njëjtën strukturë pa kaluar një ditë e plotë.[24]

Nga ana tjetër, dështimi i ultimatumit e kishte inkurajuar Beogradin të ndërmerre veprime të reja terroriste kundër shqiptarëve, duke errësuar fatin e tyre. Po ashtu, politikës së Perëndimit për të ndërhyrë ushtarakisht në favor të vënies së krizës nën kontroll, iu kundërvu politika zyrtare ruse. Qëndrimi i Moskës u shpreh në kërcënimet se "bota rrezikonte të kthehej në kohën e luftës së ftohtë", se do të merrte fund marrëveshja e Rosisë me NATO-n dhe se do të rrezikoheshin seriozisht marrëveshjet e çaromatimit të përgjithshëm bërthamor.[25]

Me gjithë këto rrethana Aleanca

Euroatlantike ishte e vendosur për ndërhyrje ushtarake në ish-Jugosllavi, por i diskutueshëm mbetej vetëm karakteri i ndërhyrjes: nëse do të ishte ai paqësor, apo luftarak.[26]

Sensibilizimi i faktorit ndërkombëtar, pas masakrave që bëheshin në Kosovë, e sidomos nga injorimi i marrëveshjes Hollbruk – Millosheviq, sepse gjatë gjithë kohës së ekzistimit të marrëveshjes forcat serbe i vazhdonin arrestimet, vrasjet, zhvillonin luftë të pashpallur, që kurrë nuk pushonte, duke e fyer në këtë mënyrë edhe vetë Misionin Vëzhgues Ndërkombëtar me sjellje jonjerëzore. Për këtë është referuar çdo ditë para faktorit vendimmarrës të botës e sidomos para Aleancës ushtarake të NATO-s. Kjo ishte një fyerje e pashembullt e bashkësisë ndërkombëtare dhe e personave të caktuar që kishin ndikim në rrjedhat botërore të kohës. Një lloj cinizmi, një lloj injorimi që arriti ta hidhëronte tej mase bashkësinë ndërkombëtare.[27]

Në muajin janar 1999 gjendja u rëndua edhe më shumë. Misioni i Hollbrukt dështoi, ndërsa armëpushimi i premtuar mori fund. Regjimi i Beogradit filloi të vepronte në mënyrë kriminale kundër popullsisë civile shqiptare. Vëzhguesit e huaj[28] zbuluan varre masive dhe të dhëna të tjera të masakrimit të shqiptarëve. Përfaqësuesi i posaçëm i OSBE-së për Kosovë, Knut Vollebek, paraqiti në mediet botërore pamje të tmerrshme të dhunës serbe, duke përfshirë masakrën e Reçakut,[29] e cila, përfundimisht, hoqi mundësinë e një marrëveshjeje për paqe në bisedime të drejtpërdrejta shqiptaro-serbe, siç ishte propozuar disa vjet me radhë. U krijua bindja se dhuna serbe kundër Kosovës kishte marrë formën klasike të një gjenocidit të egër primitiv.

Në mbledhjen e 29 janarit 1999, që u mbajt në Londër, Grupi i Kontaktit vendosi thirrjen e bisedimeve politike ndërmjet dy delegacioneve: të Kosovës dhe të Beogradit për të arritur një marrëveshje të re politike për paqen rajonale dhe për statusin e ardhshëm të Kosovës. Grupi i Kontaktit zgjodhi kështjellën e Rambujesë (Rambouillet), rezidencë qeveritare në afërsi të Parisit si vend i mbajtjes së takimit.[30]

Shqiptarët e mirëpritën vendimin e fuqive evro-amerikane për zhvillimin e bisedimeve jashtë Jugosllavisë. Dokumenti i Rambujesë njihet me emrin "Marrëveshje e ndërmjetme për paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë". Në rrethana mjaft komplekse të bisedimeve në Rambuje arriti sekretarja e Shtetit, Medlin Ollbrajt, e cila bisedoi intensivisht me shqiptarët për t'i bindur që ta nënshkruajnë në mënyrë të njëanshme projektin. Pikëpamjet amerikane në këtë periudhë kritike për fatin e marrëveshjes ishin:

Nëse të dy delegacionet do të nënshkruanin, një trupë ushtarake do të vendosej posaçërisht në Kosovë;

Nëse marrëveshja do të nënshkruhej vetëm nga pala shqiptare, NATO-ja do ta ndëshkonte regjimin e Beogradit për mospranimin e paqes dhe Nëse as delegacioni shqiptar s'do ta nënshkruante marrëveshjen atëherë do të mbetej të rishqyrtohej

edhe një herë mundësia e ndërhyrjes së avacionit të Aleancës Euroatlantike në ish-Jugosllavi.[31]

Vendimi për pranimin e marrëveshjes së Rambujesë u mor në delegacionin shqiptar, në kushtet e një presioni të fortë psikologjik e politik të jashtëm e të brendshëm. Nënshkrimi i dokumentit të Rambujesë ka qenë fitore politike dhe diplomatike. Prej këtij momenti shqiptarët panë përfundimisht se janë të përkrahur dhe se interesat e tyre nuk janë në kundërshtim me interesat e bashkësisë ndërkombëtare.[32]

Institucionet ndërkombëtare u njoftuan me këtë "gjysmë suksesi", kurse delegacioni shqiptar fitoi përkrahje në opinionin ndërkombëtar. Më 24 mars, disa ditë pas nënshkrimit të njëanshëm të marrëveshjes nga pala shqiptare në Paris dhe refuzimit të saj nga pala serbe, aviacioni i NATO-s goditi territorin e ish-Jugosllavisë.

Pra, Perëndimi e kuptoi se duhej intervenuar ushtarakisht në dobi të Kosovës, se liria e saj ishte jo vetëm synim i ndershëm i shqiptarëve, por edhe një vlerë e qytetërimit perëndimor.[33]

U bombarduan aeroportet kryesore të ish-Jugosllavisë: në Beograd e në Podgoricë. U bombardua edhe Aeroporti i Prishtinës. NATO-ja nisi goditjet ajrore edhe të objekteve strategjike të Serbisë, industrisë dhe instalimeve ushtarake, rezervave shtetërore e karburanteve, rrjetit televiziv të dezinformimit, institucionet e administratës ushtarake-politike. Këtij veprimi iu nënshtrua edhe ekonomia e Kosovës dhe e Malit të Zi.

Dy muaj pas fillimit të operacioneve ndëshkuese, NATO-ja raportoi se kishte shkatërruar 1/3 e ushtrisë dhe të teknikës serbe dhe në të njëjtin shkallë ishin shkatërruar sistemet makro-ekonomike.[34]

Në anën tjetër si u pritën sulmet e NATO-s në Kosovë më së miri na rrëfen një nga komandantët më të njohur të OKB-së, Ramush Haradinaj: "Kur kalonin avionët, neve na ngjallej shpresa se nuk ka përfunduar gjithçka... Është e papërshtetshme goditja e NATO-s në Kralan e Gërgoc, derisa po zhvilloheshin luftimet për mbrojtjen e të vetmit territor të lirë në Kosovë, që ishte prapavija jonë e mbushur përplot me popullatë civile".[35] Kurse për gjendjen në taborin e armikut thotë: "Pas fillimit të goditjeve ajrore të NATO-s, forcat serbe qysh në ditën e parë e kishin humbur luftën. U ka ra morali dhe vlera si ushtri. Ushtria e tyre nuk ka qenë më ushtri. Kanë qenë grupe njerëzish të dezorganizuar, që kanë vepruar në bazë të logjikës së momentit...".[36]

Rrjeti televiziv botëror i ndoqi zhvillimet në ish-Jugosllavi hap pas hapi, pothuajse pa ndërprerë, derisa Beogradi vendosi dëbimin e korrespondentëve të huaj. Edhe pas këtij vendimi, vëmendja e ndërkombëtarëve ndaj këtyre ngjarjeve mbeti e njëjtë.

Peshën më të madhe në operacione e mbajtën amerikanët dhe anglezët. Franca vuri në dispozicion të Aleancës avionët "Mirage", ndër më modernët, kurse Italia lejoi përdorimin e bazës së Avianos. NATO planifikoi organizimin e misioneve ndëshkuese edhe duke u nisur prej bazave detare në Adriatik.[37]

Kundërshtarë kryesorë e veprimeve

të NATO-s në ish-Jugosllavi ishte Moskë. Ajo u përpoq me çdo kusht t'i jepte krizës në ish-Jugosllavi karakterin e krizës së institucioneve ndërkombëtare, duke e vënë në pikëpyetje aftësinë e tyre për ta mbrojtur rendin botëror.

Megjithëkëtë, NATO në maj të vitit 1999 përmbodhi kushtet e saj për ndërprerjen e bombardimeve në pesë pika të palëkundshme. Një përpjekje për rishikimin e tyre u bë me propozimin italo-gjerman në mbledhjen e Grupit të vendeve të zhvilluara apo G-7 plus Rusisë, që të arrihej një projekt tjetër paqeje me "tetë pika". Ky projekt kishte pëlqimin edhe të Rusisë. Ai përmbante edhe angazhimin e drejtpërdrejtë të OKB-së për t'u dhënë fuqi ligjore operacioneve të ndërhyrjes me anë të një rezolute të Këshillit të Sigurimit.[38]

Në planet e NATO-s nuk parashihej një ndërhyrje me trupa tokësore. Mirëpo, regjimi i Beogradit i shtoi mbi 40 000 trupa ushtarake përveç formacioneve paramilitare dhe të policisë speciale në Kosovë. Kundrejt popullsisë u bënë masakra dhe barbari që ua kalonin edhe atyre të kryera nga nazifashistët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shpërngulja masive e shqiptarëve nga Kosova mori trajtën e një eksodi biblik. Në këto rrethana u vendos që të fillojnë përgatitjet për një operacion të këmbësorisë. Për këtë qëllim në Shqipëri u dërgua një teknikë e lartë ushtarake, duke përfshirë edhe helikopterë supermodernë "Apach". Ndërsa në Maqedoni u instaluan forca të reja ushtarake dhe në javën e fundit të majit u vendos që numri i trupave të NATO-s të dyfishohej deri në 45 000 veta.[39]

Përballë goditjeve shkatërrimtare ushtarake dhe ekonomike, Slobodan Millosheviqi u përpoq të jepte shenja zbutjeje: lironi tre ushtarë amerikanë të zënë rob në Maqedoni, u përpoq të mashtronte se po fillonte një tërheqje të trupave, si dhe lejonte të shkonte në Itali presidenti i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, që ishte mbajtur peng deri atëherë në Prishtinë. Më 27 maj 1999 Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e akuzoi Millosheviqin si kriminel lufte (bashkë me tre pushtetarë të tjerë të lartë) për krime kundër njerëzimit të cilat ishin dokumentuar gjerësisht.

Më 3 qershor 1999 Parlamenti i Jugosllavisë së mbetur u detyrua t'i miratonte parimet e një marrëveshjeje, të paraqitur nga ndërmjetësit ndërkombëtarë. Biseditimet për zgjidhjen e çështjeve teknike për tërheqjen e trupave serbe nga Kosova nisën në Kumanovë (FYROM), por u ndërpre në pa sukses.

Atëherë, më 8 qershor, u miratua nga G-8 një projektrezolutë, për t'ia paraqitur Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Po atë ditë në Këln të Gjermanisë, me ndërmjetësimin e sekretares së shtetit të ShBA-së, Medlin Ollbrajt, u organizua takimi i udhëheqësve shqiptarë të Kosovës: dr. Ibrahim Rugova, akademik Rexhep Qosja dhe Hashim Thaçi, që ritheksuan se do t'i përmbaheshin Marrëveshjes së Rambujesë, duke kërkuar të drejtën për referendum në fund të protektoratit ndërkombëtar.

Më 10 qershor Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën për Kosovën, në bazë të së cilës, më 12 qershor 1999, trupat e NATO-s filluan të hyjnë në Kosovë krahas tërheqjes së të gjitha forcave



ushtarake serbe. Me këtë akt lufta në Kosovë u quajt e përfunduar.[40]

Meqenëse ky vështrim i shkurtër ishte i përqendruar tërë kohën kryesisht në qëndrimin dhe rolin që kishte dhe që pati, faktori ndërkombëtar ndaj çështjes shqiptare, atëherë këtë shkrim tonin po e përmbyllim me fjalët e një përfaqësuesi të lartë ndërkombëtar, paraqitja e të cilit çdoherë ngjalle shpresa te shqiptarët, si brenda në Kosovë ashtu edhe anekënd botës, ku ishin të shpërngulur më se një milion shqiptarë: "Dhe në fund, le të më lejohet të them, shkruan Jamie Shea në shkrimin "Krizë e Kosovës dhe mediet: A e kemi bindur viktimën, shqiptarët e Kosovës, se po e mbrojmë çështjen e tyre? Po, e kemi bërë këtë. Kur unë isha në Prishtinë, vazhdon Shea, menjëherë pas fushatës, me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, një zonjë m'u afrua dhe më tha: "Zoti Shea, ju ishit linja jonë jetësore kah optimizmi". "Linjë jetësore kah optimizmi", përsërit Shea.[41]

Kurse komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ramush Haradinaj, lidhur me rolin e faktorit ndërkombëtar gjatë luftës së fundit në Kosovë, nënvizon: "Lufta jonë u dëshmuja jo aq shumë në organizim të fuqishëm, jo me ndonjë kapacitet të madh goditës. Lufta jonë kishte karakter ngacmues ose mbrojtës. Kjo nuk mjaftonte për ta bindur Millosheviqin për të hequr dorë nga Kosova. Kështu që angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare në këtë luftë ishte shumë i dobishëm për ta përcaktuar fitoren. Bile, ne jemi të nderuar dhe jemi fatlumë, sepse nevojja për sakrificë ka mundur të zgjasë me vite të tëra apo edhe në pafundësi".[42]

[1] M. Piraku, Vetëvendosja e Kosovës në dritën e Lëvizjes Antifashiste, Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave Historike, 21-1991, Prishtinë, 1993, f. 38.

[2] Halil Matoshi, Kuvendi i Kosovës 1945-1999 (2), Zëri, 3 nëntor 2001, f. 9.

[3] Ana Lalaj, Aspiratat e popullit shqiptar të Kosovës, në Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 279.

[4] Po aty.

[5] G. Zajmi, Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë e madhe dhe madhore e kohës dhe ndaj kohës (Republika e Kosovës dhe programi kombëtar), në Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 245.

[6] Blerim Shala, Sali Berisha dhe Kosova, Zëri, 5 nëntor 2001, f. 9; Miranda Vickers, Roli i Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore, në Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 252

[7] S. Kelmendi, Qëndrimi i shteteve të Evropës ndaj Republikës së Kosovës dhe çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi, në

Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 429.

[8] Iljaz Ramajli, Si u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Zëri, 3 nëntor 2001, f. 9.

[9] Po aty.

[10] E. Biberaj, Kosova: Ballkani fuqi baroti, në Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 301.

[11] Edhe në legjisllacionin ndërkombëtar të derisotëm, dokumenti që shpreh relativisht qartë se kush mund ta ushtrojë të drejtën e vetëvendosjes, është Konventa për të Drejtat Civile e Politike e vitit 1966 (botuar më 1966). Artikulli i saj deklaron: Të gjithë popujt kanë të drejtë të vetëvendosin. Në bazë të kësaj të drejte ata mund: Lirisht të vendosin statusin e politik dhe ta ndjekin zhvillimin e tyre ekonomik, social e kulturor. Shih: International Covenant on Civil and Political Right, art. 1, 1976.

[12] G. Zajmi, Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë e madhe dhe madhore e kohës dhe ndaj kohës (Republika e Kosovës dhe programi kombëtar), punim i cit., f. 245.

[13] K. Priti, Konsiderata etnike dhe historike rreth çështjes së bashkimit kombëtar të shqiptarëve, në Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 238.

[14] Po aty: Zgjedhjet e dyta parlamentare dhe presidenciale të Kosovës janë mbajtur më 22 mars 1998, në 26 njësi zgjedhore, që përfshijnë 92 zona zgjedhore, ndërsa zgjedhjet nuk janë mbajtur në 3 njësi zgjedhore (Skenderaj, Drenas /Glogoc/ dhe Klinë), që përfshijnë 8 zona zgjedhore, pra nga ku duhej të zgjidheshin 8 deputetë. Zgjedhjet janë mbajtur sipas sistemit të kombinuar, pra 92 deputetë janë zgjedhur në votime të drejtpërdrejta, ndërsa 26 deputetë janë zgjedhur sipas sistemit proporcional, nga subjektet elektorale që kanë fituar 3 për qind të votave të përgjithshme, duke përjashtuar LDK-në që ka fituar mbi 50 për qind të votave të përgjithshme. Në Kosovë ishin evidencuar 867 704 zgjedhës, pa shqiptarët në botën e jashtme, të cilët nuk janë thirrur në votime.

Nga ky numër në votime kanë dalë 736 566 votues ose 85.18 për qind. Ndërsa kandidati i vetëm për president të shtetit, dr. Ibrahim Rugova, i kandiduar nga LDK-ja, fitoi 99.2 për qind të votave. Kuvendi i Kosovës, i dalë nga këto zgjedhje, u mbledh vetëm dy herë: Në sesionin konstituiv, në korrik të vitit 1998 dhe në atë të shpërbërjes, në janar të vitit 2000. Halil Matoshi, Kuvendi i Kosovës 1945-1999 (2), punim i cit., f. 9.

[15] S. Kelmendi, Qëndrimi i shteteve të Evropës ndaj Republikës së Kosovës dhe çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi, punim i cit., f. 429.

[16] Halil Matoshi, Kuvendi i Kosovës 1945-1999 (2), punim i cit., f. 9.

[17] Po aty.

[18] Elez Biberaj, Kosova: Ballkani fuqi baroti, punim i cit., f. 299.

[19] Kjo njihet edhe si Doktrina e Klintonit: Nxjerrë nga: Fjalimi i Përirimit të Presidentit Klinton, The New York Times, 21 janar 1993, f. A. 25 shih: S. Repishti, Koncepti i vetëvendosjes dhe aktualiteti kosovar, në Çështja e Kosovës – një problem historik

dhe aktual, Tiranë, 1996, f. 341.

[20] Po aty f. 341.

[21] Po aty.

[22] Bardh Hamzaj, Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj, Zëri, Prishtinë, 1999, f. 96.

[23] Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë, 1999, f. 148.

[24] Kosova në vështrim enciklopedik, vep. e cit., f. 149.

[25] Po aty f. 149-150.

[26] Po aty, f. 150.

[27] Bardh Hamzaj, Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 137.

[28] Në shtator të vitit 1998 bashkësia ndërkombëtare reagoi me ashpër ndaj krimeve të forcave serbe në Kosovë dhe sidomos shqetësohej për katastrofën humanitare, e cila, me ardhjen e të ftohtit, kërcëonte të merrte përmasa të papara.

Kështu, u bë marrëveshja Hollbruk-Millosheviq, në bazë të së cilës në Kosovë do të vinin 2000 verifikues të paarmatosur të OSBE-së. Kjo marrëveshje, thekson R. Haradinaj, ishte një shpëtim për UÇK-në.

Kjo marrëveshje ka qenë e një rëndësie vendimtare dhe ka ndihmuar ringjalljen e ushtrisë. Po ashtu, vazhdon R. Haradinaj, bashkësia ndërkombëtare përmes tyre njihet me të vërtetën e Kosovës për së afërmi, e jo përmes gazetarëve, apo përmes misioneve që vinin nga një javë e të cilëve Serbia ua fshihte të vërtetën, duke maskuar kështu barbaritë e veta. Kjo ishte njëherësh edhe parapërgatitje e fushatës ajrore të NATO-s që do të pasonte më vonë. Shih në: B. Hamzaj, Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 107-108.

[29] Reagimi i amerikanit William Voker, se kjo çka ka ndodhur në Reçak është krim, rrethanat ndërkombëtare u rënduan aq shumë, sa nxitën lëvizjen vendimtare të mekanizmeve vendosëse në drejtim të zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës. Prandaj, është edhe e arsyeshme e gjithë ajo simpati e popullit shqiptar ndaj ShBA-së. Shih në: Bardh Hamzaj, Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 138.

[30] Po aty f. 140.

[31] Kosova në vështrim enciklopedik, vep. e cit., f. 145.

[32] Bardh Hamzaj, Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 142-143.

[33] B. Shala, Dëshmi se Kosova e ka merituar lirinë, shih: Bardh Hamzaj, Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 179.

[34] Kosova në vështrim enciklopedik, vep. e cit., f. 151-152.

[35] Bardh Hamzaj, Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 147.

[36] Po aty f. 148.

[37] Kosova në vështrim enciklopedik, vep. e cit., f. 152.

[38] Po aty.

[39] Po aty.

[40] Po aty f. 152-153.

[41] Jamie Shea, Kriza e Kosovës dhe mediat (8), Koha ditore, Prishtinë, 17 nëntor 1999, f. 5.

[42] Bardh Hamzaj, Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj, vep. e cit., f. 142.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ekipi nga UEFA Grow, me përshtypje në Kosovë

PRISHTINË, 7 DHJETOR - Ekipi nga UEFA Grow është ndarë tejet i kënaqur me vizitën në Kosovë në kuadër të mbështetjes së hartimit të strategjisë së investimeve kapitale të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Ata gjatë kësaj vizite treditore, krahas takimeve me krerët e federatës dhe të gjithë sektorët e saj, kanë takuar edhe ministrin e Sportit, kreun e komunës së Prishtinës, si dhe partnerët e FFK-së.

Në përfundim të vizitës së tyre, kryetari Agim Ademi dhe dy nënkryetarët, Bakir Burri e Agim Dibrani, i kanë falënderuar ata për përkushtimin dhe punën e tyre me qëllim të hartimit të një plani të

përbashkët strategjik. Ndërkaq, përshtypjet e tyre për këtë vizitë pune ata i dhanë për faqen zyrtare të FFK-së. “Në tri ditët e fundit patëm një punë shumë intensive dhe produktive. Jemi shumë të inspiruar me atë që kemi parë këto ditë këtu. E kemi një ekip të mrekullueshëm në federatë dhe jeni vend me rini shumë të mirë. Së bashku po shohim rrugën përpara në zhvillim të futbollit. Është kënaqësi e jona që ta sjellim përvojën nga e tërë bota dhe së bashku t'i gërshetojmë strategjitë drejt zhvillimit të futbollit në Kosovë. Ka qenë një vendosmëri e madhe e federatës për hartimin e kësaj strategjie dhe tani presim të



vazhdojmë punën”, ka theksuar kryesuesi i ekipit UEFA Grow, Oleksandr Kucheriavyi. Fjalë të mira për ekipin e FFK-së

dha edhe anëtari tjetër i këtij ekipi, Adam Walker. Ai ka deklaruar se të gjitha takimet kanë qenë të dobishme dhe është punuar me

përkushtim. “Kemi kuptuar më shumë rreth punës tuaj fantastike sidomos drejt lojës së zhvillimit të lojës së futbollit. Ka qenë një privilegj i jashtëzakonshëm të vinim këtu dhe të mësonim për vendin tuaj, por edhe për zhvillimin e futbollit, në mënyrë që të jemi në gjendje t’ju ndihmojmë në hartimin e planit strategjik”, ka thënë ai.

Ndërkaq Phil Taylor ka theksuar se pas tri ditëve intensive me shumë biseda përmbajtësore, tani është koha për t’i ndërlidhur të gjitha idetë dhe diskutimet në një plan strategjik, i cili do të ketë ndikim për një të ardhme të ndritur të futbollit të Kosovës.

Kosova mëson kundërshtarët për kualifikimet U17 dhe U19 për vajza

NION, 7 DHJETOR - Në selinë e UEFA-s në Nion të mërkurën është bërë tërheqja e shortit për kualifikimet e grupmoshave nën 17 dhe nën 19 vjeç në konkurrencën e vajzave. Përfaqësuesja e Kosovës U17, e cila arriti të promovohet në Ligën A të kualifikimeve për “Euro 2023” si skuadra me bilancin më të mirë nga pozita e dytë, do të bëjë pjesë në Grupin 5, ku janë të përfshira edhe Republika e

Irlandës, Franca dhe Italia. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në Francë, më 23, 26 dhe 29 mars të vitit 2023. Liga A përbëhet nga 28 ekipe. Shtatë fituesit eventualë të grupeve do të kualifikohen në Kampionatin Evropian, i cili mbahet në Estoni. Skuadrat që përfundojnë në vendin e katërt në grupe do të bien në Ligën B për raundin e parë kualifikues të edicionit 2023/24. Ndërkohë, Përfaqësuesja U19 do të marrë

pjesë në kualifikimet e Ligës B për “Euro 2023”, ku është përfshirë në Grupin 3, së bashku me Irlandën e Veriut, Qipron dhe Letoninë. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen më 4, 7 dhe 10 prill të vitit 2023 në Irlandën e Veriut. Fituesit e secilit grup dhe skuadra me bilancin më të mirë nga pozitat e dyta do të promovohen në Ligën A për t’i vazhduar më pas kualifikimet drejt Evropianit 2023.



Shaqiri: U kërkoj falje tifozëve që nuk e bëmë paraqitjen e zakonshme



Doha, 6 dhjetor - Përfaqësuesja e Zvicrës, në krye me dyshen shqiptare Granit Xhakën dhe Xherdan Shaqirin, janë eliminuar nga Kupa e Botës në 1/16 e finales nga Portugalia e cila triumfoi thellë dhe siguroi “biletën” për çerekfinale. “Helvetikët” u mposhtën 6:1 nga kombëtarja iberike. Futbollisti nga Zhegra e Gjilanit, Xherdan Shaqiri, pas ndeshjes u ka kërkuar falje tifozëve zviceranë. “Jemi shumë të zhgënjyer. Në emër të ekipit u kërkoj falje të gjithë

tifozëve që nuk arritëm ta bënim paraqitjen tonë të zakonshme. Ne kemi plane të mëdha, por ky është futboli, herë pas here tregohen limitet. Kështu ishte edhe sot. Ne e humbëm lojën në pjesën e parë dhe më pas ju po ndiqni lojën. Ju, gjithashtu, duhet t’i përgëzoni portugezët për golat, por rezultati ishte padyshim shumë i lartë”, ka thënë Shaqiri, njofton “Blick.ch”. Xherdan Shaqiri u paraqit për 90 minuta në këtë duel, duke krijuar në rast të mirë shënimi në pjesën e parë nga guajtja e lirë.

Blatter, pas humbjes së Zvicrës: Ku ishte Granit Xhaka?

CYRIH, 7 DHJETOR - Ish-presidenti i FIFA-s, Sepp Blatter, ka reaguar pas humbjes turpëruese që Zvicra pësoi nga Portugalia (6-1). Ai ka zgjedhur ta sulmojë Granit Xhakën, i cili është edhe kapiteni i skuadrës,

duke thënë se nuk ka influencë në ndeshjet e rëndësishme. “Ishte si ndeshje tenisi. Zvicra humbi 6-1. Ku ishte Granit Xhaka? Ai duhet të jetë lideri, ai ngre zërin, por nuk ka influencë në ndeshjet e rëndësishme. Pas

dy javësh e gjysmë në Kupën e Botës, fjalët e Granit Xhakës se dëshiron të shikojë Zvicrën si kampione bote duken si një listë e parealizuar Krishtlindjesh”, ka deklaruar ish-kreu i FIFA-s.



Giroud: Ndhem si një 20-vjeçar, pjesa tjetër është përvojë

DOHA, 7 KORRIK - Olivier Giroud nuk ka ndër mend të ndalet si nga dëshira për të shënuar sa më shumë ashtu edhe nga ajo për të luajtur me fanellën e kombëtares së Francës. Sulmuesi i Milanit ka qenë protagonist në këtë botëror edhe pse në moshën

36-vjeçare. Gjithsesi, duket se me kalimin e kohës ai është përmirësuar. Giroud ka ndihmuar Francën të shkojë në çerekfinalet e botërorit Katar 2022, ku do të luajë ndaj Anglisë. "Ndhem mirë dhe vazhdoj të jem në një nivel të kënaqshëm

pavarësisht se jam 36 vjeç. Dikush më ka thënë se në fushë jemi të gjithë 20-vjeçar, pjesa tjetër është përvojë", ka thënë Giroud. "Ndaj, luaj njësoj sikur të isha 20 vjeç, me mentalitetin e një djaloshi. Kam urinë për të fituar këtë kompeticion dhe objektivin

për të ngritur sërish lart Kupën e Botës. Trupi im e përballon këtë event. Nuk kam limite dhe dua t'u tregoj të rinjve të kenë durim në karrierë. Nëse mund t'i shoqëroj sa më gjatë këta të rinj, do të jetë një kënaqësi", u shpreh Giroud.



Tre 'mbretër' në garë për një Kupë Bote

DOHA, 7 DHJETOR - Botërori i Katarit është shansi i fundit i Leo Messit për t'u bërë i "pavdekshëm", për ta fituar trofeun e vetëm që i mungon në CV e tij mbresëlënëse, Kupën e Botës. Messi po kalon një moment fantastik, ka bërë liderin tek Argjentina duke udhëhequr përfaqësuesen e tij deri në fazën e çerekfinales. "Pleshti" ka realizuar tri gola dhe ka dhuruar një asistimë, ka thyer disa rekorde, por as që ka ndër mend të ndalet këtu, në këtë kërcim të tij të fundit shpreson të festojë me të artën në duar. Messi nuk është i vetmi që e dëshiron këtë trofe. Në garë me kohë të plotë janë shumë yje të tjerë, por për momentin rivalët e tij më të mëdhenj janë dy miqtë e tij te PSG-ja, Neymar dhe Mbappe. Neymar kaloi makthet e lëndimit dhe u rikthye në kohë



rekorde duke u rikthyer me gol. Neymar ka pas një superekip, Brazili i tij shihet favoriti kryesor për ta fituar këtë Botëror. Fatet e Messit dhe Neymarit mund të kryqëzohen në gjysmëfinale. Nga krahu tjetër, Kylian Mbappe ka diçka më shumë se dy miqtë e tij. Në katër ndeshje Mbappe është

pa diskutim lojtari më i mirë i këtij Botërori, të paktën deri më tani, teksa ka shënuar pesë gola dhe dhuruar dy asistime. Mbappe ka, gjithashtu, një superskuadër në dispozicion. Mbappe mund të përballat me Messin ose Neymarin vetëm në finalen e madhe.

Lakersat ndalen pas tri fitoreve



REZULTATET

Cleveland - Lakers	116-102
Miami - Detroit	96-116
Denver - Dallas	115-116

CLEVELAND, 7 DHJETOR - Pas tri fitoreve ndalet skuadra e lakersave, që u mund me rezultat 116-102 nga Clevelandi, në një ndeshje të dominuar shumicën e kohës nga vendasit. Davis luajti vetëm tetë minuta, pasi ishte i sëmurë, ndërsa LeBron James realizoi 21 pikë, shumë pak për të shpresuar te fitorja. Për vendasit u dallua Donovan Mitchell me 43 pikë. Zhgënjën sërish

skuadra e Miamit, që u mund me rezultat 116-96 nga Detroiti, sfidë ku për miqtë u dallua Bogdanoviç, autor i 31 pikëve. Vendimtar edhe stoli, nga ku erdhën 57 pikë. Fitore në sekondën e fundit për Dallasin, që mposhti Denverin (116-115). Luka Donçiqi realizoi një "triple bouble" (22 pikë, 10 rebounde, 12 asistime) dhe Hardaway 29 pikë.

Gjendja shëndetësore e Peles po përmirësohet

Mjekët kanë konfirmuar se gjendja e legjendës braziliane Pele është duke u përmirësuar. 82-vjeçari Pele është shtruar në spital tash e një javë për të trajtuar një infeksion respirator

të rënduar nga Covid-19. Ai pritet të largohet nga spitali kur të shërohet plotësisht nga infeksioni. "Ai ka shenja të qëndrueshme jetësore, është i vetëdijshëm dhe pa

komplimente të reja", thuhet në njoftimin e spitalit Albert Einstein në Brazil. Pele, tri herë fitues i Kupës së Botës, po lufton kancerin dhe po i nënshtrohet kimioterapisë.

Në Katar imazhi i Peles duke festuar golat dhe duke ngritur trofe me kombëtaren e Brazilit u shfaq në bluzat, flamujt dhe pankartat e tifozëve brazilianë që ishin mbledhur të hënën

përpara ndeshjes së Kupës së Botës kundër Koresë së Jugut. Pele kishte thënë se do ta shikonte ndeshjen nga spitali. Brazili fitoi 4-1 për të kaluar në çerekfinale.

SHKURT

Hazardi pensionohet nga kombëtarja

Kombëtarja e Belgjikës e mbylli Kupën e Botës 2022 në mënyrën më të keqe të mundshme duke u eliminuar që në fazën e grupeve, kurse ylli i kësaj kombëtare Eden Hazard ka vendosur të pensionohet. "Një faqe mbyllet sot... Faleminderit për dashurinë dhe për përkrahjen e pashoq! Faleminderit për të gjithë kënaqësinë e ndarë që nga viti 2008! Vendosa t'i jap fund karrierës me kombëtare. Pasuesit tashmë janë aty. Do të më mungoni djelmossa", ka shkruar Hazard. Lajmin e ka konfirmuar edhe faja zyrtare e Kombëtares së Belgjikës.

Trajneri i Zvicrës: Portugalia ishte më e mirë, ne nuk u shfaqëm në fushë

Trajneri Murat Yakin ka thënë se Portugalia ishte më e mirë se Zvicra, prandaj edhe e siguroi kualifikimin në çerekfinale. "Portugalia ishte më e mirë. Ne nuk u shfaqëm në fushë. Ishim gjithmonë vonë dhe nuk ishim kurrë gati për të bërë atë që duhej. Unë jam ende krenar për udhëtimin që kemi. Grupi ynë ishte i nivelit të lartë dhe djemtë bënë gjëra të mëdha në këtë Botëror", ka thënë Yakin.

Ronaldo: Rezultat historik për Portugalinë

Cristiano Ronaldo nuk ishte titullar në ndeshjen që Portugalia e fitoi me rezultat bindës (6-1) kundër Zvicrës. Ai ka folur pas kësaj fitore, duke thënë se rezultati ka qenë historik për portugezët në kompeticionin më të madh në botë për futboll. "Ditë e pabesueshme për Portugalinë, me një rezultat historik në kompeticionin më të madh në futbollin botëror", ka shkruar pesë herë fituesi i "Topit të Artë". "Ekspozita luksoze e një ekipi plot talent dhe i ri. Përzgjedhja jonë është për t'u përgëzuar. Ëndrra është e gjallë! Deri në fund! Forca, Portugali!", ka shtuar Ronaldo.

'Bild': Kombëtarja e Gjermanisë e ndarë në dy grupe

Eliminimi i hershëm i Gjermanisë nga Kupa e Botës 2022 nuk ka shkuar pa u hetuar nga mediet gjermane. Raportime të "Sport Bild" kanë nisur të zbulojnë disa prapaskena që lidhen me kombëtaren dhe eliminimin e saj të hershëm nga Katar 2022. Një nga problemet që thuhet të ketë ndikuar më së shumti në eliminimin e kombëtares gjermane është ndarja e lojtarëve në dy grupe. Gjithnjë sipas "Bild", "blloku i Bayernit" shkaktoi një ndarje të skuadrës së Gjermanisë, me Hansi Flick që iu dha atyre besim më shumë sesa duhej. Flick më parë ka qenë trajner i Bayern Munchenit dhe kjo mund të jetë një nga arsytet pse disa lojtarëve iu dha gjithë ky besim. Mbetet të shihet nëse do të ketë konfirmime apo raportime të tjera për "përçarjen" e kombëtares gjermane.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Lina-Ks" Sh.p.k Harilaq, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e materialeve izoluese & dekorues kombinuar me stiropor dhe pllaka kliner në Harilaq, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.01.2023 në ora 10:00 në zyrën e kompanisë "Lina-Ks" Rr. Antenes nr. 200, Harilaq, Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga Kompania "Lina-Ks" Sh.p.k Harilaq, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e materialeve izoluese & dekorues kombinuar me stiropor dhe pllaka kliner në Harilaq, Fushë Kosovë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/74978664293?pwd=b3lPaTVISGFHUGhEWWtkbWhsUksrdz09>

Meeting ID: 749 7866 4293
Passcode: FhBsV6

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Lina-Ks" Sh.p.k Harilaq, Fushë Kosovë për impiantin për prodhimin e materialeve izoluese & dekorues kombinuar me stiropor dhe pllaka kliner në Harilaq, Fushë Kosovë.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shemsije Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Kreshnik Vorfaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Vëllezërit Frasheri " Pllaneje.

- Skender Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Dion Ethem shpall të pavlefshme dëftesën e kl. njëmbëdhjetë të shkollës "Mileniumi i Tretë" Prishtinë.

- Hekuran Krasniqi nga Demjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. kongresi manastirit Demjan KK Gjakovë nga kl. I-V dhe nga kl. VI-IX.

- Kujtese Kokalla nga Cermjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Amet Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

- Kastriot Mucaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Elvis Susuri shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Eldina Bajsini shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Burim Fazliu (Krasniqi) shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Andi Shefqeti shpall te pavlefshme diplomën dhe vërtetimin e lëshuar për gjendjen e notave dhe mungesave shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Redon Mazreku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Edison Mazreku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Albnor Ibrahim shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren

- Albina Dumnica B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330445842.

- Agron Merovci nga Vushtrria shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Bujqësore tash "Avdyll Frashëri" drejtimi Veterinë.

- Sahit Kurhasku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Ali M. Hasi" Crmjan KK Gjakovë nga kl.I-VII.

- Avdullah Guta nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Artan Rrahmani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Auto Mekanik.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

